




Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020



Autorë: Marija Babović
Juna Miluka

Raporti i Indeksit të Barazisë Gjinore për Shqipërinë u hartua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, brenda kuadrit të Instrumentit të Asistencës para Anëtarësimit (IPA) të Bashkimit Evropian, financuar nga Bashkimi Evropian. Raporti i Indeksit të Barazisë Gjinore për Shqipërinë u shkrua me mbështetjen e Bankës Botërore dhe Expertise France.

Botimi bazohet mbi metodologjinë e Indeksit të Barazisë Gjinore 2017, të hartuar nga EIGE për Bashkimin Evropian dhe shtetet e tij anëtare. (<https://eige.europa.eu/gender-equality-index>). Të dhënat e përdorura për llogaritjen e Indeksit të Barazisë Gjinore për Shqipërinë i referohen vitit 2018.

Botimi u realizua me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ky raport është përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me asistencën e Institutit Evropian për Barazi Gjinore dhe eksperteve të mbështetur nga BB dhe French Expertise Marija Babović dhe Juna Miluka bazuar në të dhënat e përlllogaritura nga INSTAT dhe të konfirmuara nga EIGE. Zyra e Delegacionit Evropian në Shqipëri ka asistuar përgjatë gjithë procesit.

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtimeve	IV
Shkurtimet e vendeve	IV
Parathënie	V
Gjetjet kryesore	VI
1. Hyrje	1
1.1 Kuadri konceptual	1
1.2 Metodologjia	2
2. Konteksti në Republikën e Shqipërisë	4
2.1 Konteksti social-ekonomik	4
2.2 Institucionet dhe Politikrat që lidhen me Barazinë Gjinore	6
3. Indeksi i Barazisë Gjinore në Republikën e Shqipërisë	9
3.1 Indeksi i Barazisë Gjinore në Shqipëri	9
3.2 Fusha e punës	10
3.3 Fusha e parasë	14
3.4 Fusha e dijeve	16
3.5 Fusha e kohës	19
3.6 Fushat e pushtetit	21
3.7 Fusha e shëndetit	24
4. Konkluzione	27
Referencat	28
Shtojca 1:	29
Fushat, nënfushat, treguesit dhe burimet e të dhënave	29
Shtojca 2:	41
Rezultatet për fushat, nënfushat dhe vlerat e treguesve për Indeksin e Barazisë Gjinore për Shqipërinë 2020	41

Lista e shkurtimeve

ADHS	Sondazhi i Demografisë dhe Shëndetit të Shqipërisë
EIGE	Instituti Evropian për Barazinë Gjinore
KC	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
EQLS	Sondazhi Evropian për Cilësinë e Jetës
EWCS	Sondazhi Evropian për Kushtet e Punës
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
LFS	Sondazhi i Forcës së Punës
SILC	Statistikat për të Ardhurat dhe Kushtet e Punës

Shkurtimeve të vendeve

Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian			
AT	Austria	IT	Italia
BE	Belgjika	LT	Lituanian
BG	Bullgaria	LU	Luksemburgu
CY	Qipro	LV	Letonia
CZ	Çekia	MT	Malta
DE	Gjermania	NL	Holanda
DK	Danimarka	PL	Polonia
EE	Estonia	PT	Portugalia
EL	Greqia	RO	Rumania
ES	Spanja	SE	Suedia
FI	Finlanda	SI	Sllovenia
FR	Franca	SK	Sllovakia
HR	Kroacia	RS	Serbia
HU	Hungaria	UK	Mbretëria e Bashkuar
IE	Irlanda	BE-28	28 Shtete Anëtare të BE-së
Vendet Kandidate të BE-së			
AL	Shqipëria	MK	Maqedonia e Veriut
RS	Serbia		

Parathënie

Raporti i parë i Indeksit të Barazisë Gjinore në Shqipëri 2020, synon të dokumentojë arritjet e Qeverisë Shqiptare, në lidhje me përparimin e bërë për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore në Shqipëri. Vitet e fundit është punuar intensivisht për ratifikimin e një sërë dokumentash ndërkombëtarë dhe për harmonizimin e legjislacionit vendas me këto dokumenta. Po kështu edhe politikat, strategjitë, planet e veprimit apo ndërhyrjet konkrete janë fokusuar në të njëjtin qëllim, për të ofruar mundësi të barabarta për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në familje dhe shoqëri.

Për të dokumentuar të gjitha arritjet e bëra në këtë drejtim, por edhe për të evidentuar se cilat janë fushat që kanë nevojë për më shumë ndërhyrje për përmirësim, vendosëm të publikojmë këtë raport, për herë të parë këtë vit dhe Shqipëria është vendi i tretë ndër vendet që aspirojnë të hyjnë në familjen evropiane, që ka arritur të prodhojë Indeksin Kombëtar të Barazisë Gjinore, në Ballkanin Perëndimor.

Indeksi i Barazisë Gjinore për Shqipërinë u përgatit me mbështetjen e Institutit Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), mbështetjen e Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE), në kuadër të bashkëpunimit të tyre për Instrumentin e Ndihmës të Para-Anëtarësisë (IPA), financuar nga Bashkimi Evropian në përputhje me metodologjinë e EIGE.

Raporti analizon situatën dhe arritjet në gjashtë fusha kryesore: puna, paratë, njohuritë, pushteti, koha dhe shëndeti, si dhe dy fusha të ndërthurura: pabarazitë dhe dhuna.

Nga njëra anë jemi të kënaqur me përparimin kryesisht në drejtim të vendim-marrjes apo shëndetësisë, nga ana tjetër evidentojmë fusha ku ende stereotipet dhe rolet gjinore ndërhyjnë duke i kthyer përpjekjet tona në sfida.

Raporti i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e Bankës Botërore, sjell një pasqyrim të saktë të zhvillimeve por, edhe të fushave ku ende nevojitet të punohet për të pasur arritje drejt barazisë gjinore. Mbështetje e rëndësishme është ofruar edhe nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, përgjatë gjithë përgatitjes së raportit. Ndaj të gjithë këtyre institucioneve dhe organizatave partnere e bashkëpunëtoresh, ndiej nevojën të shpreh falenderime e mirënjohje të veçantë!

Sigurimi i integritetit të vajzave dhe grave, nxitja e të drejtave të tyre social-ekonomike, mbështetja e grupeve të pafavorizuara, si dhe angazhimi i burrave dhe djemve në të gjitha veprimtaritë që synojnë fuqizimin e grave dhe dhënien e mundësive të barabarta, do të jenë disa prej objektivave të punës së ministrisë sonë. Çdo hap në këtë aspekt, do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e barazisë gjinore, dhe krijimin e mundësive të barabarta e progresin e vazhdueshëm të shoqërisë sonë.

Ogerta Manastirliu

Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gjetjet kryesore

Indeksi i përgjithshëm i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë për vitin 2017 shënoi 60.4, duke demonstruar një hendek gjinor të konsiderueshëm. Kjo gjetje konfirmon nevojën për ripërtëritjen e angazhimeve dhe përpjekjeve të aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe qeverinë, sektorin privat, shoqërinë civile dhe qytetarët për arritjen e barazisë së plotë gjinore.¹ Në të vërtetë, Indeksi i Barazisë Gjinore për Shqipërinë është 7 pikë më poshtë se mesatarja e BE-28 (67.4), me përjashtim të fushës së *qeverisjes*, ku Shqipëria ka më shumë barazi gjinore sesa BE-28. Mangësitë më të mëdha në krahasim me BE-28 hasen në fushat e

njohurive, parasë dhe kohës, kurse të ngjashme rezultatet janë në fushën e *punës dhe shëndetit*.

Shqipëria renditet mes të gjitha vendeve që e raportojnë Indeksin e Barazisë Gjinore, që përfshin të gjitha Vendet Anëtare të BE-së dhe dy vendet candidate të BE-së, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Një faktor që kontribuoi në renditjen më të mirë të Shqipërisë krahasuar me vendet e listuara janë arritjet e saj më të mira në fushën e *qeverisjes* sesa në shumicën e vendeve anëtare të BE-së (60.9 përkundrejt 51.9 për BE-28).



Rezultati për fushën e *punës* është 67.6, me një situatë më të mirë në fushën e *pjesëmarrjes* sesa në fushën e *ndarjes* dhe *cilësisë së punës*. Ashtu si në situatën në të gjithë BE-në, ndarja gjinore në tregun e punës është ende e dukshme dhe e pasqyruar në përqendrimin më të lartë të grave në sektorë si shërbimet sociale.



Në fushën e *parasë*, rezultati prej 59.6 rrjedh nga një situatë veçanërisht e pafavorshme në nënfushën e *burimeve financiare*, ku maten pabarazitë në të ardhura dhe fitime mes grave dhe burrave.



Në fushën e *dijes*, rezultati prej 55.6 tregon një hendek ende të madh gjinor në të dy këto nënfusha: *arritjet dhe pjesëmarrja*, dhe *ndarja e punës*. Ndonëse ka më shumë gra të arsimuara sesa burra në Shqipëri, ato zënë një vend relativisht më të vogël krahasuar me nivelet e BE-së dhe objektivat kombëtarë. Ndarja sipas fushave të arsimit është ende e dukshme, ku studentet femra që ndjekin arsimin e lartë përqendrohen në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies, shkencave humane dhe arteve, ndërsa studentët meshkuj që studiojnë në këto fusha janë të pakët.



Fusha e *kohës* ka rezultatin më të ulët të indeksit (48.1), duke treguar përgjegjësi shumë të paekuilibruara lidhur me kujdesin për anëtarët e familjes dhe punën e papaguar në familje. Ndonëse gratë mbajnë shumicën e këtyre përgjegjësisë, ato nuk marrin pjesë aq sa burrat në aktivitetet sociale të rëndësishme për mirëqenien dhe cilësinë e jetës së tyre.



Fusha e *pushtetit* shënon 60.9 dhe e rendit Republikën e Shqipërisë në vendin e 6^{të} në krahasim me pjesën tjetër të vendeve që raportojnë mbi Indeksin e Barazisë Gjinore. Ky rezultat i lartë vjen nga përfaqësimi i lartë i grave në *pushtetin politik dhe ekonomik*. Nga ana tjetër, *pushteti social* i grave, d.m.th. përfaqësimi në organet e bordeve organizative të kërkimeve shkencore, financimit, medias dhe sporteve kryesore mbetet prapa me progresin në pushtetin politik dhe ekonomik.



Fusha e *shëndetësisë* shënon rezultatin më të lartë prej 81.8 (ndonëse ende nën rezultatin e BE-28 prej 88.1). Nënfushat e *statusit shëndetësor* dhe *aksesit në kujdes shëndetësor* paraqesin hendeqe më të ulëta gjinore sesa *sjelljet e shëndetit* që prekin faktorët e rrezikut dhe mënyrat e shëndetshme të jetës.

¹ Indeksi i Barazisë Gjinore mat barazinë gjinore në një shkallë prej 1 (pabarazi e plotë) deri në 100 (barazi e plotë).

1. Hyrje

Indeksi i Barazisë Gjinore si instrument i Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) mat pabarazitë gjinore në Bashkimin Evropian (BE) në përputhje me kontekstin² e politikave të BE-së. Është një tregues i përbërë që ofron një masë të konceptit kompleks të barazisë gjinore në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së dhe në kohë në vazhdimësi. Indeksi i Barazisë Gjinore ofron një masë që mat *hendeqet gjinore*, duke marrë parasysh edhe *nivelet e arritjeve* në çdo fushë. Si i tillë, Indeksi i Barazisë Gjinore i EIGE siguron që një rezultat i mirë të jetë pasqyrim si *i dallimeve të pakta gjinore, ashtu edhe i niveleve të larta të arritjeve*. Për këtë arsye, ai është *si matje e barazisë gjinore, ashtu edhe e kohezionit social*. (EIGE 2013a: 7-8).

Indeksi i Barazisë Gjinore mat barazinë gjinore në *gjashtë fusha thelbësore*: puna, paraja, dijet, koha, pushteti, shëndeti dhe në dy fusha të tjera: ndërthurjen e pabarazive dhe dhunës, bazuar në kuadrot konceptuale specifike.

1.1 Kuadri konceptual

Fushat përzgjidhen duke u nisur nga kuadri konceptual, i cili përfshin konceptet e ndryshme teorike mbi barazinë gjinore: konceptin e ngjashmërisë, dallimit, dhe konceptin e qasjes gjinore transformuese (EIGE, 2013a: 7-9). Në thelb të Indeksit të Barazisë Gjinore qëndrojnë tre qasje të ndërthurura dhe të mbështetura te njëra-tjetra.

Qasja e bazuar tek 'pikëpamja e të qenit të njëjtë' vë në pah domosdoshmërinë e përfshirjes së grave në një botë, nga e cila ato kanë qenë zakonisht të përjashtuara. Politikat e barazisë duhet të bëjnë përpjekje për arritjen e neutralitetit gjinor dhe për t'i përçar praktikave dhe vlerat mbizotëruese tek të gjithë individët. Dallimet mes femrave dhe meshkujve i atribuohen zakonisht një identiteti gjinor të gdhendur në procesin e përvojave të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe që zakonisht i vendos femrat në një pozicion të disavantazuar në krahasim me meshkujt. Kjo qasje kritikohet, sepse 'standardi mashkullor' mbetet standardi që femrat duhet të arrijnë. Problemi qëndron në faktin se femrat mund të shihen

si 'anëtare të reja' në fushat e mbizotëruara nga meshkujt, të papajisura me burimet e përshtatshme (Walby, 2005, cituar nga EIGE, 2013a: 7). Kështu, të gjithëve u imponohet një normë, një 'mënyrë të qeni, të bëri, të pari dhe të vlerësuarit të gjërave' (mënyra mashkullore). Kjo qasje përmban një lloj thjeshtimi të përkatësisë gjinore, perceptimin e identitetit gjinor si një botë binare, me dy kategori që prezumohen homogjene, kategoria e burrave dhe të grave.

Qasja e bazuar tek 'pikëpamja e të qenit të ndryshëm' pasqyron një lëvizje drejt vlerësimit të barabartë të kontributeve të ndryshme që japin aktualisht meshkujt dhe femrat në një shoqëri të ndarë nga ana gjinore. Sipas kësaj qasjeje, ndryshimet mes femrave dhe meshkujve të shprehura në modele të ndryshme jetese, në psikologji dhe në vlera të ndryshme, duhet të vihen në shënjestër të ndërhyrjeve që përpiqen të sjellin më shumë barazi sesa ndjesinë e të qenit të njëjtë (Cockburn, 1991, cituar nga EIGE, 2013: 8). Identitetet gjinore perceptohen shpesh në shumës, ku hierarkitë njihen brendapërbrenda kategorive të ndryshme të meshkujve dhe femrave. Kjo qasje kritikohet shpesh për shkak të rënies në grackën e esencializmit dhe bazimit të saj te konceptet esencialiste të femërores dhe mashkullores, duke përforcuar stereotipet dhe organizimin aktual të ndarjes gjinore të roleve në ekonominë prodhuese dhe riprodhuese (kujdesit) (Fraser, 1997, marrë nga EIGE, 2013a: 8). Kjo qasje është kritikuar edhe për kapacitetin e saj të ulët për t'i ndryshuar gjërat, për zhvendosjen e vëmendjes te përkujdesja për fëmijët dhe të moshuarit dhe te rendet dhe regjimet gjinore ekzistuese.

Qasja e transformimit gjinor është ajo, sipas së cilës në vend që të zgjidhet midis qasjes së të qenit të njëjtë dhe qasjes së të qenit të ndryshëm, krijohet një standard i ri për gratë dhe burrat, duke çuar në transformimin e marrëdhënieve gjinore (Walby, 2005, 2009, marrë nga EIGE, 2013a: 8). Kjo qasje aspirojnë 'të shkojë përtej gjinisë' dhe të fokusohet jo vetëm te përjashtimi i grave ose burrave si normë, por edhe tek e gjithë mënyra se si vetë bota me gjinitë është e ndërtuar (Verloo, 2005, marrë nga EIGE, 2013a: 8).

² EIGE, Indeksi i Barazisë Gjinore, <https://eige.europa.eu/gender-equality-index/about>

Përveç qasjeve ndaj barazisë gjinore, bazat teorike të Indeksit të Barazisë Gjinore sipas EIGE-së mund të ndeshen edhe në qasje të tjera, si tek *zhvillimi i njerëzimit* dhe *fuqizimi i grave* (më shumë gjendet në EIGE, 2013a: 9-10). Ndonëse barazia gjinore shihet si një çështje e zhvillimit të njerëzimit, qasja e Indeksit të Barazisë Gjinore largohet nga fuqizimi i

grave dhe përfaqon konceptin e *qasjes gjinore*. Ajo përfshin modelin universal të përkujdesjes sipas Fraser (1997), ku barazia gjinore si 'ndarja e barabartë e punës së paguar, parasë, njohurive, pushtetit vendimmarrës dhe kohës' shihet si kryesore (1997) (Plante nga et al, 2009, marrë nga EIGE, 2013a: 10).

Përfshirja e Indeksit të Barazisë Gjinore në Kuadrin e Politikave të BE-së

Bazuar në perceptimin se progresi sa i përket barazisë gjinore në BE mbetet i kufizuar pavarësisht faktit që barazia gjinore ka qenë në fokusin e politikëbërjes së BE-së që prej përfshirjes së pagës së barabartë në Traktatin që përcaktoi Komuniteti Ekonomik Evropian në vitin 1957, Instituti Evropian i Barazisë Gjinore (EIGE) zhvilloi Indeksin e Barazisë Gjinore, me qëllim mbështetjen e një politikëbërjeje më efektive në këtë fushë. Indeksi i Barazisë Gjinore u prezantua për herë të parë në vitin 2013 dhe rezultatet e para treguan se BE-ja kishte nevojë për më shumë monitorim dhe politika më të qartë të barazisë gjinore. Përditësimi i vitit 2015 përfshiu për herë të parë të dhënat rreth dhunës ndaj grave dhe në vitin 2017 të dhënat e fokusuar në pabarazitë e kombinuara me karakteristika të tjera. Ai është përditësuar në vitin 2019, duke përfshirë edhe një fokus tematik te ekuilibri mes punës dhe jetës. Që prej vitit 2019, Indeksi thelbësor i Barazisë Gjinore do të përditësohet çdo vit, duke u fokusuar më thellë në një fushë të përzgjedhur për secilin vit.

1.2 Metodologjia

Indeksi i Barazisë Gjinore i EIGE-së është zhvilluar përmes kombinimit të treguesve të përzgjedhur (dimensione³ të bazuara konceptualisht) të barazisë gjinore në një masë të vetme përmbledhëse. Si i tillë, Indeksi i Barazisë Gjinore përfaqëson një mjet të sofistikuar që e sintetizon këtë ndërlikim në një masë të lehtë për t'u përdorur dhe lehtësisht të interpretueshme (EIGE, 2015).

Indeksi i Barazisë Gjinore mat barazinë gjinore në një shkallë nga 1 (pabarazi e plotë) deri në 100 (barazi e plotë) *në gjashtë fusha thelbësore*: puna, paraja, njohuritë, koha, pushteti, shëndeti dhe në *dy fusha të tjera*: pabarazitë dhe dhuna që ndërthuren me njëra-tjetrën.

Figura 1: Fushat e Indeksit të Barazisë Gjinore



3 Fushat janë zgjedhur duke u nisur nga analizat e thelluara të dokumenteve kryesore të politikave për barazinë gjinore në BE dhe në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë edhe Kartën e Komisionit Evropian për Gratë të vitit 2010. Strategjia e Komisionit Evropian për Barazi mes Grave dhe Burrave 2010-15, Pakti i Këshillit të Bashkimit Evropian për Barazi Gjinore 2011-20, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Platforma e Pekinit për Veprim

Çdo fushë ndahet më tej në nënfusha, të cilat maten nëpërmjet treguesve të ndryshëm individualë. Këto nënfusha mbulojnë çështjet kyçe brenda sferave tematike përkatëse, në përputhje me kuadrin konceptual. Një sistem

më i detajuar matjeje për çdo fushë dhe nënfushë paraqitet në kapitujt kushtuar secilës fushë.

Tabela 1: Fushat dhe nënfushat e Indeksit të Barazisë Gjinore

Fushat	Nënfushat
Puna	Pjesëmarrja, ndarja dhe cilësia e punës
Paraja	Burimet financiare, situata ekonomike
Dijet	Arritjet dhe pjesëmarrja, ndarja
Koha	Aktivitetet përkujdesjes, aktivitetet shoqërore
Pushteti	Pushteti politik, pushteti ekonomik, pushteti shoqëror
Shëndeti	Gjendja, sjellja dhe aksesimi
Pabarazitë gjithëpërshkuese	Analizuar sipas tipologjisë së familjes, moshës, aftësisë së kufizuar, nivelit të arsimit, kontekstit rural-urban, etj.
Dhuna	Përhapja, shkalla, raportimi

Në indeks janë futur edhe dy fusha të tjera, por që nuk ndikojnë në rezultatin përfundimtar. Fusha e pabarazive gjinore të kombinuara me karakteristika të tjera nxjerr në pah se si manifestohen pabarazitë gjinore të kombinuara me moshën, aftësinë e kufizuar, vendlindjen, arsimin dhe llojin e familjes. Fusha e dhunës ndaj grave mat dhe analizon përvojat e dhunës së grave. (EIGE, 2015: 11).⁴

Për zhvillimin e Indeksit të Barazisë Gjinore, EIGE përdori kriteret e rrepta sa i përket cilësisë së të dhënave, konkretisht aksesueshmërinë e të dhënave, shpeshtësinë dhe krahasueshmërinë e tyre (mes vendeve dhe periudhave të ndryshme kohore). Një shpjegim i detajuar mbi matjet dhe llogaritjet gjendet në EIGE 2013a dhe EIGE 2013b.

Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë llogaritet duke ndjekur metodologjinë e zhvilluar nga

projekti i EIGE "Rritja e kapaciteteve të vendeve kandidate të BE-së dhe të vendeve të mundshme kandidate për matjen dhe monitorimin e ndikimit të politikave të barazisë gjinore (2018-2021)" në kuadrin e Instrumentit të Asistencës para Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian dhe financuar nga Bashkimi Evropian. Raporti për Indeksin e Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë është hartuar bashkërisht nga Instituti i Statistikave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me mbështetjen e Bankës Botërore. Llogaritjet janë vlerësuar në mënyrë të pavarur nga EIGE. Të dhënat e përdorura për llogaritjen e indekseve i përkasin periudhës 2015-2018, ku shumica e treguesve janë matur në vitin 2018. Tabela e metadatave - përkufizimi i treguesve, burimet dhe vitet, të cilave u referohen të dhënat, paraqiten në Shtojcën 1.

⁴ Mbi dhunën gjinore, shiko INSTAT, 2019. "Studim kombëtar mbi popullsinë i vitit 2018: Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri," INSTAT: Tiranë.

2. Konteksti në Republikën e Shqipërisë

2.1 Konteksti social-ekonomik

Treguesit social-ekonomikë hedhin dritë mbi kontekstin në të cilin analizohet Indeksi i Barazisë Gjinore. Shqipëria ka shënuar progres të konsiderueshëm sa i përket zhvillimit ekonomik, gjë që ka rezultuar në ulje të varfërisë dhe në një rritje më të madhe ekonomike. Shqipëria u godit nga kriza globale financiare pas vitit 2008 dhe kjo çoi në ulje të rritjes ekonomike, duke arritur nivelin e saj më të ulët në vitin 2013 menjë rritje reale të PBB-së prej 1.0 për qind.⁵ Rritja ekonomike filloi të kthehej në ritmet e mëparshme vite më vonë, duke arritur në 3.8 për qind në vitin 2017, duke tejkaluar nivelin prej 2.4 për qind të BE-28. Megjithatë, PBB-ja për frymë është shumë më e ulët në Shqipëri sesa në BE-28. Në vitin 2017, PBB-ja për frymë e Shqipërisë ishte 4,024 Euro krahasuar me 27,780 Euro për BE-28. Sektorët kryesorë ekonomikë që kontribuojnë në rritjen ekonomike janë shërbimet, industria, ndërtimi dhe bujqësia. Shërbimet përbëjnë 48 për qind të PBB-së në Shqipëri dhe janë rritur me 6.6 për qind në vitin 2017 në terma realë. Industria dhe ndërtimi përbëjnë 20.4 për qind të PBB-së me një shkallë rritjeje reale prej 1.8 për qind për industrinë dhe 7.0 për qind për ndërtimin në vitin 2017. Në të njëjtin vit, bujqësia përbënte 19.0 për qind të PBB-së dhe një rritje reale prej më pak se një për qind. (Tabela 3).

Tendencat demografike tregojnë se popullata shqiptare parashikohet të ulet, kryesisht për shkak të shkallës së ulët të fertilitetit dhe migrimit të vazhdueshëm jashtë shtetit. Popullsia shqiptare deri më 1 janar 2019 llogaritej të ishte 2.9 milionë dhe parashikohet të ulet në 2.7 milionë deri në vitin 2031. Në uljen e popullsisë kandiduaredhe ulja e vazhdueshme e fertilitetit që prej vitit 2013. Në vitin 2018, shkalla e fertilitetit

ishte 1.37 lindje të gjalla në grupmoshën riprodhuese, që është edhe niveli më i ulët që prej vitit 2013 (1.73). Shkalla e fertilitetit është më e ulët se shkalla e zëvendësimit dhe mesatarja e BE-28 (1.59 lindje të gjalla për grua). Përveç kësaj, Shqipëria ka vazhduar të përjetojë migracion, ndonëse në nivel shumë më të ulët sesa valët më të mëdha të migrimit të viteve 1990. Vitet e fundit, njerëzit kanë migruar kryesisht për mundësi pune dhe arsimimi jashtë shtetit. Në vitin 2018 emigruan 38,703 vetë.⁶ Si rrjedhojë e shkallëve të larta të emigrimit, Shqipëria ka pasur në të kaluarën sasi të mëdha remitancash, të cilat përbënin 28përqind të PBB-së në vitin 1993. Megjithatë, me dobësimin e lidhjeve familjare me vendin përkatës, filluan të bien edhe remitancat, të cilat kanë rënë gradualisht duke filluar që nga viti 2000. Në vitin 2018, ato përbënin rreth 9.7 për qind të PBB-së.⁷

Arritjet në arsim në Shqipëri tregojnë një hendek të madh krahasuar me mesataren e BE-28 si për burrat, ashtu edhe për gratë, ndërkohë që hendeku gjinor favorizon djemtë në klasat më të ulëta dhe më pas, në arsimin e lartë, është më shumë në favor të vajzave. Arritjet për të rriturit e moshës 25 vjeç e sipër janë afërsisht 2 vjet më të ulëta se sa mesatarja e BE-28. Burrat kanë arritje në arsim 0.5 vjet më shumë se gratë (10.25 krahasuar me 9.75), ndonëse situata është e kundërt për grupmoshën më të re prej 20-39 vjeç (mesatarisht 10.6 përkundrejt 11 vjet). Në fakt, përqindja e grave me arsim të lartë është më e lartë sesa e burrave.⁸ Regjistrimi në arsimin parashkollor tregon një hendek të madh mes Shqipërisë me 76.3 për qind dhe BE-28, ku 95.4 për qind e fëmijëve regjistrohen në arsimin parashkollor. Dhe ndërkohë që regjistrimi i djemve dhe vajzave është pothuajse i barabartë në BE-28, në Shqipëri ka një shkallë më të lartë regjistrimi tek djemtë.

5 INSTAT. Llogaritë Kombëtare. <http://instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/#tab2>

6 INSTAT. Numri i Emigrantëve, Migrantëve, Migrimi i Ri, 2014-2018. <http://instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik-percentC3-percentAB-dhe-social-percentC3-percentAB/migracioni-dhe-integrimi-i-migrant-percentC3-percentABve/#tab2>

7 Banka Botërore. Remitancat personale të marra (% e PBB)- Shqipëri. <https://data.worldbank.org/indicator/BX.TRF.PWKR.DT.GD.ZS?locations=AL>

8 Shih <http://dataexplorer.wittgensteincentre.org/wcde-v2/>

Tregu i punës tregon pabarazi mes grave dhe burrave në Shqipëri, të cilat janë më të mëdha sesa në BE -28. Gratë kanë shkallë më të ulët punësimi dhe pjesëmarrjeje në forcën e punës, si dhe një shkallë më të lartë pasiviteti për shkak të përgjegjësiave familjare. Treguesit e tregut të punës për Shqipërinë qëndrojnë pas atyre të BE-28. Të rinjtë në Shqipëri kanë shkallën më të ulët të punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcën e punës, si dhe shkallën më të lartë të papunësisë krahasuar me pjesën tjetër të popullatës⁹. Dallimi më i madh në treguesit e tregut të punës mes grave dhe burrave qëndron tek shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, me një dallim prej 17.2 për qind. Shkalla e papunësisë në Shqipëri është pothuajse dy herë më e lartë se ajo e BE-28. Ndonëse burrat kanë shkallë pak më të lartë papunësie sesa gratë në Shqipëri, statistikave të papunësisë shfaqin kryesisht mospunësimin sa duhet të grave, duke qenë se një përqindje e madhe llogariten të punësuar në punë të papaguara familjare. Përfundimisht, diferenca gjinore në paga është 10.7 për qind në Shqipëri dhe 16.0 për qind në BE-28. Duhet theksuar se dallimi gjinor në paga në Shqipëri llogaritet nga pagat e deklaruara në tatime. Si rrjedhojë e informaliteti, pagat shpesh raportohen si më të ulëta sesa janë realisht, sidomos pagat më të larta, që u përkasin burrave. Rrjedhimisht, dallimi gjinor në paga duket më i vogël. Dallimi gjinor në paga i llogaritur përmes të dhënave të vrojtimit është rreth 15.2 për qind¹⁰.

Me gjithë dallimet në tregun e punës, gratë përballen edhe me një barrë të dyfishtë, duke qenë se janë ato që mbajnë kryesisht përgjegjësi për punën e papaguar në shtëpi, e cila fokusohet veçanërisht tek punët e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijët. Pavarësisht statusit të tyre të punësimit, gratë bëjnë një pjesë shumë më të madhe të punës së papaguar të kujdesit. Të dhënat e vrojtimit të vitit 2011 për Përdorimin e Kohës tregojnë se mbi 90 për qind e grave, pavarësisht statusit të tyre të punësimit, marrin pjesë në punë të papaguar krahasuar me më pak se 50 për qind të burrave. Përveç kësaj, gratë e punësuar i kushtojnë rreth 4 orë punës së papaguar krahasuar me më pak se një orë që i kushtojnë homologët e tyre burra. Ky dallim është shumë më i madh në rastin e grave të papunësuar. Gratë e papunësuar shpenzojnë rreth 6 orë për të bërë punë të papaguar krahasuar me rreth një orë që shpenzojnë burrat e papunësuar.

Përfundimisht, përfaqësimi i grave në vendimmarrje është rritur në nivel legjislativ dhe ekzekutiv. Gratë përfaqësojnë 29.3 për qind të anëtarëve të Parlamentit ose 41 gra deputete nga 140 deputetë që ka Parlamenti gjithsej.¹¹ Gjatë legjislaturës 2013-2017, gratë përbënin 23.5 për qind të deputetëve të Parlamentit. Ka, gjithashtu, edhe një rritje të përfaqësimit të grave në Parlament. Aktualisht, 57 për qind e qeverisë përbëhet nga ministre gra, numër që është rritur nga përfaqësimi prej 42 për qind në qeveri në vitin 2013.

Tabela 3: Treguesit social-ekonomikë për Shqipërinë dhe BE-28

Treguesit	Shqipëria ¹²	BE-28 ¹³
Prirjet Demografike		
Popullata më 1 janar 2019 (në milionë)	2.9	512.4
Përqindja e grave në totalin e popullsisë, në përqindje, në vitin 2019	50.1	51.0
Parashikimi i popullsisë për vitin 2031 (në milionë)	2.7	521.3
Shkalla e lindshmërisë (numri i fëmijëve të lindur të gjallë për grua në periudhën e lindshmërisë)	1.37	1.59
Emigracioni	38,703	3.1
Zhvillimi Ekonomik		
PBB për frymë (në euro, për vitin 2017)	4,024	27,780
PBB, rritja reale në përqindje, 2017	3.8	2.4
Kapitali Njerëzor dhe Punësimi		
Regjistrimi në arsimin parashkollor, në përqindje	76.3	95.4
Vajza	78.9	94.8
Djem	81.6	94.7

9 Të rinjtë në BE-28 përfshijnë grupmoshën 19-24 vjeç.

10 Golla, Anne Marie, and María Eugenia Dávalos. 2012. "Boshllëqet gjinore në Shqipëri përmes syve të Varfërisë dhe mirëqenies së përbashkët: Rezultatet nga 2012 LSMS." Banka Botërore, Uashington, DC.

11 "Raporti i Monitorimit i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020" (2018).

12 Burimi: Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT). www.instat.gov.al

13 Burimi: Eurostat. <https://ec.europa.eu/eurostat>

Burimi: Të dhënat e Bankës Botërore. <https://data.worldbank.org/>

Burimi: Të dhënat e OECD-së. <https://data.oecd.org/emp/employment-by-activity.htm>

Treguesit	Shqipëria ¹²	BE-28 ¹³
Regjistrimi në arsimin e lartë, në përqindje	55.0	69.0
Gra	66.4	77.0
Burra	43.8	62.0
Arritjet në arsim në përqindje (mosha 25 vjeç e lart)		
Gratë me arsim të lartë	17.2	34.5
Burrat me arsim të lartë	15.7	30.1
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, në përqindje	68.3	73.9
Gra (mosha 15-64 vjeç)	59.7	68.4
Burra (mosha 15-64 vjeç)	76.9	79.4
Të rinjtë (mosha 15-29 vjeç)	50.1	42.5
Shkalla e Punësimit, në përqindje	59.5	68.8
Gra (mosha 15-64 vjeç)	52.4	63.5
Burra (mosha 15-64 vjeç)	66.7	74.1
Të rinjtë (mosha 15-29 vjeç)	38.5	36.1
Shkalla e Papunësisë, në përqindje	12.8	6.9
Gra (mosha 15-64 vjeç)	12.3	7.2
Burra (mosha 15-64 vjeç)	13.2	6.7
Të rinjtë (mosha 15-29 vjeç)	23.1	15.1
Dallimi gjinor në paga, në përqindje	10.7	16.0

Shënim: Këto të dhëna janë për vitin 2018, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe.

2.2 Institucionet dhe Politikat që lidhen me Barazinë Gjinore

Shqipëria ka bërë hapa të konsiderueshëm në ngritjen e një sistemi institucional, hartimin e politikave relevante dhe në anëtarësimin në angazhime të ndryshme ndërkombëtare. Legjislacioni kombëtar për barazinë dhe antidiskriminimin i ka rrënjët në të drejtat dhe liritë themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar në vitin 1998. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹⁴, përmes nenit të saj 18 shprehet se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se askush nuk duhet të diskriminohet padrejtësisht për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare apo filozofike, gjendjes ekonomike, arsimit, statusit social apo prejardhjes. Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"¹⁵ synon specifikisht garantimin e mbrojtjes nga diskriminimi gjinor. Ai gjithashtu parashikon masa kundër praktikave diskriminuese, dispozita kundër diskriminimit dhe për rolin e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen nga diskriminimi në punë, në arsim, në procesin e vendimmarrjes dhe në media. Ligji sanksionon përgjegjësitë e punëdhënësit në lidhje me të drejtat e barabarta për të

dyja gjinitë sa i përket rekrutimit, kushteve të barabarta të punës, pagesës së barabartë për punë me vlerë të barabartë, si dhe për mundësi të barabarta. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë një mbrojtje të efektshme nga diskriminimi gjinor, si edhe nga çdo lloj sjelljeje që nxit diskriminimin gjinor. Ai përcakton masat që garantojnë mundësi të barabarta për burrat dhe gratë për të eliminuar diskriminimin me bazë gjinore të çfarëdolloj forme dhe parashikon përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore qendrore dhe lokale për zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave që nxisin barazinë gjinore në shoqëri. Përveç kësaj, Ligji Nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"¹⁶ shkon përtej diskriminimit gjinor, duke përfshirë shumë shkaqe diskriminimi. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë të drejtën e çdo individi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi mundësish dhe mundësi për ushtrimin e të drejtave, gëzimin e lirive dhe pjesëmarrjen në jetën publike, si dhe mbrojtje të efektshme nga diskriminimi dhe nga çdo lloj sjelljeje që nxit diskriminimin. Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat

14 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18. <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/untc/unpan013810.pdf>

15 <http://www.osce.org/albania/36682?doxnload=true>

16 http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/ed_protect/protrav/ilo_aids/documents/legaldocument/wcms_178702.pdf

kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, ndryshuar me Ligjin Nr. 47/2018 synon të parandalojë dhe të reduktojë të gjitha format e dhunës në familje nëpërmjet masave të përshtatshme ligjore dhe të nevojshme, si edhe të sigurojë përmes tyre mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Dhuna në familje dhe format e tjera të dhunës ndaj grave konsiderohen krime në Shqipëri sipas Ligjit Nr. 7895 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”¹⁷, datë 27.01.1995 dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 36/2017 dhe Ligjin Nr. 89/2017.

Kuadri institucional në lidhje me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje shtrihet në nivel kombëtar dhe lokal. Autoriteti kryesor kombëtar i ngarkuar me këto çështje është ministri i ngarkuar me barazinë gjinore¹⁸. Në vitin 2017, qeveria ia caktoi këtë detyrë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)¹⁹. Struktura që mbulon barazinë gjinore në MSHMS është “Sektori i politikave dhe strategjive për përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore”, pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme për Politikën dhe Zhvillimin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Përveç kësaj, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është edhe kreu i Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGJ)²⁰. KKBGJ-ja është njësi më e lartë këshilluese në lidhje me barazinë gjinore dhe integrimin gjinor për politikën që kanë të bëjnë me përfaqësimin në politikë, fuqizimin ekonomik, në fushat sociale dhe kulturore, etj. Ky këshill përbëhet nga nëntë përfaqësues të ministrive të linjës, të përfaqësuar nga zëvendësministrat ose autoritete të tjera të larta, si edhe tre përfaqësues të shoqërisë civile. Përveç kësaj, Zëvendëskryeministri²¹ është caktuar si autoriteti koordinues kombëtar për barazinë gjinore, me qëllim përforcimin e makinerisë gjinore. Sipas Ligjit Nr. 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”, secila ministri linje ka një pikë fokale. Edhe në nivel lokal, ka të punësuar gjinorë në çdo bashki, të cilët më shumë bashkëluajnë edhe rolin e koordinatorëve lokalë kundër dhunës në familje.

Edhe parlamenti ka disa struktura në mbështetje të barazisë gjinore. Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave, i cili është ngritur në vitin 2017, është pjesë e Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet sociale dhe Shëndetin. Qëllimi i këtij

nënkomisioni është të mbikëqyrë zbatimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, të raportojë mbi situatën e dhunës në familje dhe diskriminimit ndaj gruas, dhe për këtë ai mban seanca dëgjimore me grupet e interesuara dhe aktorët e ndryshëm institucionalë. Përveç kësaj, është edhe “Aleanca e deputeteve gra”, e themeluar në vitin 2013 për të promovuar barazinë gjinore në parlament dhe për të përfshirë perspektivën gjinore në legjislacion.

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²² është një strukturë e pavarur, e ngritur në vitin 2010, e cila mbron individët nga diskriminimi, duke përfshirë edhe diskriminimin gjinor. Komisioneri emërohet nga parlamenti dhe shqyrton ankesat ndaj diskriminimit të individëve apo grupeve, duke vepruar në emër të tyre ose duke mbrojtur interesat e tyre. Në juridiksionin e tij, ai mund të ndërmarrë hetime administrative, të nxjerrë vendime, të bëjë rekomandime, të vendosë sanksione dhe të përfaqësojë paditësit në gjykatë me pëlqimin e tyre.

Shqipëria ka ratifikuar në vitin 1993 Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), si dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën ndaj Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Shqipëria është shtet anëtar i Platformës së Pekinit për Veprim (1995) dhe i Rezolutës 1325 së Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë. Ajo përgatit rregullisht raporte mbi angazhimet e saj dhe mbi zbatimin e rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtare. Qeveria e Shqipërisë i ka paraqitur Komitetit GREVIO në vitin 2017 raportin e saj të parë mbi zbatimin e Konventës së Stambollit. MSHMS-ja ka përgatitur një plan veprimi, ku pasqyrohen rekomandimet e marra. Shqipëria i ka paraqitur gjithashtu raportin e saj të katërt periodik Komitetit të CEDAW në vitin 2014, për të cilin ka marrë rekomandime në vitin 2016, si edhe raporte hije nga Avokati i Popullit dhe nga organizata të shoqërisë civile. Raporti Kombëtar për Zbatimin e Platformës së Pekinit+25 u paraqit në maj të vitit 2019. Raportimi për Platformën për Veprim të Pekinit bëhet çdo pesë vjet. Për herë të parë, shoqëria civile përgatiti dhe paraqiti një raport hije në Platformën për Veprim të Pekinit. Për përpilimin e raportit ndërkombëtar mbahen konsulta dhe takime me shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtarë, Aleancën e Deputeteve Gra, etj.

17 Ligji Nr. 7895 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, datë 27.01.1995 dhe ndryshuar me Ligjin Nr.36/2017 dhe Ligjin Nr. 89/2017. <https://eurailius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation/send/10-criminal-code/11-criminal-code-en>

18 Ligji Nr. 9770, datë 18.12.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat kundër dhunës në familje”

19 Këshilli i Ministrave, Vendim Nr. 508, datë 13.09.2017

20 Ligji Nr. 9770, datë 18.12.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”

21 Urdhri i Kryeministrit Nr. 32, datë 12.2.2018 “Për caktimin e Koordinatorit kombëtar për barazinë gjinore”

22 UNWOMEN dhe UNDP. (2016). “Situaata gjinore në Shqipëri.” https://www2.unwomen.org/-/media/field_percent20office_percent20eca/attachments/publications/country/albania/unenpercent20gender_percent20brief_percent20albania_percent202016_en_web.pdf?la=en&vs=5235

Hartimi i politikave për barazi gjinore drejtohet kryesisht nga Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (SKPVBGj) 2016-2020, i cili ka katër qëllime strategjike: 1. Fuqizimi i ekonomik i grave dhe burrave, 2. Garantimi i pjesëmarrjes faktike dhe të barabartë të grave në politikë dhe në vendimmarrjen publike, 3. Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe i dhunës në familje, 4. Fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues të Mekanizmit Kombëtar për Barazinë Gjinore, si dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë mbi çuarjen përpara të barazisë gjinore. Reduktimi i varfërisë për gratë dhe vajzat është një prej objektivave të përfshirë në qëllimet e para strategjike të fuqizimit ekonomik. Ky objektiv fokusohet në reduktimin e varfërisë përmes identifikimit të tipologjive të feminizmit të varfërisë dhe zhvillon masa për reduktimin e kësaj varfërie në zonat urbane dhe rurale, si dhe për rritjen e investimeve sociale. SKPLBGj 2016-2020 parashikon edhe koordinimin e aktiviteteve me strategjitë ndërsektoriale që përfshijnë masat për uljen e varfërisë me fokus gjinor. Për veç kësaj, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Barazi Gjinore (SKAPBGj) 2016-2020 ka përcaktuar si një nga objektivat e saj reduktimin e punës së papaguar në shtëpi, duke rritur aksesin në shërbimet sociale dhe cilësinë e tyre. Rezultatet e pritshme fokusohen në ofrimin e më shumë shërbimeve sociale sa i përket kujdesit për fëmijët, kujdesit për të moshuarit, kujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe më shumë akses në këto shërbime për grupet vulnerabël si komunitetet rome dhe egjiptiane. Për të garantuar cilësinë e këtyre shërbimeve, njësitë e qeverisjes lokale pritet të bëjnë monitorim dhe vlerësim.

Mbi monitorimin e SKPVBGj 2016-2020 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale raportohet rregullisht në Këshillin Kombëtar për Barazinë Gjinore.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2016-2020, e cila përbën kuadrin strategjik për të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, përfshin edhe barazinë gjinore për më shumë gjithëpërfshirje përmes mundësive ekonomike dhe sociale, forcimit dhe mbrojtjes së sistemit të të drejtave të pronësisë dhe mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për promovimin e barazisë gjinore, rritjes së përfaqësimit dhe pjesëmarrjes në politikë dhe në vendimmarrjen publike, ndërgjegjësimit për dhunën me bazë gjinore dhe garantimit të mbrojtjes administrative dhe ligjore dhe shërbimeve mbështetëse për viktimat dhe autorët e krimit. Një sërë strategjish të tjera adresojnë fuqizimin ekonomik të grave, rritjen e mundësive në tregun e punës, mundësitë e sipërmarrjes, përfshirjen sociale, kujdesin shëndetësor, rininë,

grupet vulnerabël, luftën ndaj dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit, përfaqësuar në(i) "Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 -2020", (ii) "Planin e veprimit për mbështetjen e grave sipërmarrëse 2014-2020", (iii) Strategjinë ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri 2014-2020", (iv) "Paketën bazë të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2009", (v) "Strategjinë e Strehimit Social 2016-2025" dhe "Planin e saj të Veprimit për Strehimin", (vi) "Dokumentin e Politikave për Përfshirjen Sociale 2016-2020", (vii) "Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 dhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj", (viii) "Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015 – 2020", (ix) "Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020", (x) "Planin Kombëtar të Veprimit për Personat LGBT në Republikën e Shqipërisë 2016 -2020", dhe (xi) "Planin Kombëtar të Veprimit për Ri-integrimin Social-Ekonomik të Viktimave Gra dhe Vajza të Trafikimit në Republikën e Shqipërisë si pjesë përbërëse e "Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Trafikimit të fëmijëve 2014-2017" dhe Planit të saj të Veprimit, dhe (xi) Plani ndërinstitucional i veprimit për zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara 1325 "Për Gratë, Paqen, Sigurinë, 2018-2020".

SKPVBGj 2016-2020 përfshin në objektivat e saj edhe integrimin gjinor përmes përfshirjes së objektivave gjinorë në strategjitë e tjera sektoriale dhe në treguesit dhe buxhetimin gjinor. Integrimi gjinor po ndodh edhe në kuadrin ligjor që përfshin Ligjin Nr. 22, datë 03.05.2018 "Për strehimin social",²³ ku parashikohen dispozita për strehimin social të viktimave gra të dhunës, Ligjin Nr. 96, datë 13.10.2017²⁴ "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 110, datë 20.12.2018²⁵ "Për noterinë", që mbron të drejtat e pronësisë së grave, VKM Nr. 456/2012 "Për integrimin e barazisë gjinore në Programimin Afatmesëm të Buxhetit", etj.

Përveç kësaj, me mbështetjen e UNWOMEN, shtatë bashki janë angazhuar për miratimin e planeve të veprimit për barazinë gjinore, ndërkohë që pesë prej tyre i kanë miratuar tashmë planet e veprimit. Kjo nisim nisi në vitin 2017 pas nënshkrimit prej shtatë bashkive të Kartës Evropiane për Barazinë mes Grave dhe Burrave në Jetën Lokale. Këto plane veprimi përfshijnë treguesit për matjen e progresit, si dhe për përcaktimin e burimeve financiare të nevojshme për zbatimin e çdo aktiviteti të planifikuar. Ato janë planifikuar për t'u zbatuar brenda tre viteve të ardhshme (2018-2020) dhe për t'u rishikuar çdo vit.

23 Ligji nr. 22, datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social", <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/ligj-nr.-22-dt.-3.5.2018-Per-strehimin-social.pdf>

24 Ligji nr. 96, datë 13.10.2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë", <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>

25 Indeksi I Barazisë Gjinore Ilogaritet për Serbinë në bazë të të dhënave të vitit 2016 dhe për Maqedoninë e Veriut bazuar në të dhënat e vitit 2015.

3. Indeksi i Barazisë Gjinore në Republikën e Shqipërisë


Në këtë kapitull paraqiten rezultatet e Indeksit të Barazisë Gjinore për Shqipërinë, duke filluar nga rezultati i Indeksit të Barazisë Gjinore dhe duke vazhduar me analizimin e rezultateve sipas fushave dhe nënfushave. Të dhënat e përdorura për llogaritjen e Indeksit për Shqipërinë janë të periudhës 2015-2018, me shumicën e treguesve të matur për vitin 2018.

Situata në Shqipëri paraqitet e krahasuar me mesataren e BE-28 dhe me shtetet anëtare individuale, si dhe e krahasuar me dy vendet candidate të Ballkanit Perëndimor për Bashkimin Evropian, për të cilat llogaritet Indeksi i Barazisë Gjinore – Republika e Serbisë dhe Maqedonia e Veriut²⁶. Për secilën fushë, paraqiten politikat kryesore relevante me qëllim ofrimin e informacioneve të thelluara për mënyrën e adresimit strategjik të aspekteve të barazisë gjinore nga Republika e Shqipërisë.

3.1 Indeksi i Barazisë Gjinore në Shqipëri


Indeksi i Barazisë Gjinore në Republikën e Shqipërisë shënon 60.4 pikë dhe është 7 pikë më i ulët sesa mesatarja e BE-28 (tabela me rezultatet e të gjitha fushave dhe nënfushave, si dhe me treguesit, paraqitet në Shtojcën 2). Ka ende rrugë përpara për të arritur plotësisht barazinë gjinore, gjë që kërkon angazhim nga të gjithë aktorët, duke përfshirë qeverinë, sektorin privat, shoqërinë civile dhe qytetarët.

Figura 2: Indeksi i Barazisë Gjinore, Republika e Shqipërisë, 2017 dhe BE-28, 2017



Krahasuar me BE-28 sipas fushave, Indeksi i Barazisë Gjinore për Shqipërinë rezulton më i mirë sesa mesatarja e BE-së në fushën e pushtetit, dallime shumë të vogla në fushën e punës dhe shëndetit dhe dallime më të mëdha në fushën e parasë dhe kohës.

Figura 3: Indeksi i barazisë gjinore sipas fushave, Republika e Shqipërisë 2017 dhe BE-28 2017




26 Indeksi i Barazisë Gjinore llogaritet për Serbinë në bazë të të dhënave të vitit 2016 dhe për Maqedoninë e Veriut bazuar në të dhënat e vitit 2015.


Kur Shqipëria krahasohet me shtetet anëtare individuale të BE-së dhe me dy vendet candidate, Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut, ajo renditet e 17-ta nga 31 vende. Ajo ndodhet mes Maqedonisë së Veriut dhe Portugalisë dhe më lart se Estonia, Letonia, Bullgaria, Qipro, Serbia, Çekia, Kroacia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia, Hungaria dhe Greqia dhe pas Maltës, Italisë, Austrisë dhe Gjermanisë. Një

prej faktorëve që ka kontribuar në renditjen më të mirë të Shqipërisë krahasuar me vendet e listuara janë arritjet e saj më të larta në fushën e parasë krahasuar me shumicën e shteteve anëtare të BE-së.

Figura 4: Indeksi i Barazisë Gjinore, Republika e Shqipërisë 2017, 28 Shtete Anëtare të BE-së për vitin 2017, Republika e Serbisë 2016 dhe Maqedonia e Veriut 2015



3.2 Fusha e punës




Në **fushën e punës**, Indeksi i Barazisë Gjinore mat nivelin e aksesit që kanë si burrat dhe gratë në tregun e punës dhe nëse ata punojnë njësoj në forma cilësore të punësimit dhe kushteve të punës. Fusha e punës përfshin dy nënfusha: pjesëmarrjen dhe ndarjen në tregun dhe cilësinë e punësimit. Me **pjesëmarrje** kemi parasysh nivelin e punësimit dhe hendekun gjinor në punësimin e grave dhe të burrave, duke vënë në pah shanset që ata kanë për të gjetur punë. Kjo nënfushë kombinon dy tregues: shkallën e punësimit të ekuivalentuar me punësimin me kohë të plotë për grupmoshën 15 vjeç e sipër dhe kohëzgjatjen e jetës së punës (për popullatën e grupmoshës 15 vjeç e sipër). Shkalla e punësimit e ekuivalentuar me punësimin me kohë të plotë përftohet duke krahasuar numrin mesatar të orëve për çdo punonjës me numrin mesatar të orëve të çdo punonjësi të punësuar me kohë të plotë (EIGE, 2017b) 13) **Ndarja gjinore dhe cilësia** e punës janë elementë të nënfushës së dytë. Me ndarje kemi parasysh shpërndarjen horizontale dhe vertikale të grave dhe burrave të punësuar në sektorë të ndryshëm, profesionet e tyre dhe pozicionet vendimmarrëse. Përqendrimi i burrave dhe grave në sektorë të caktuar të ekonomisë apo profesione të caktuara tregon ndarjen horizontale gjinore, ndërsa përfaqësimi në pozicione drejtuese tregon ndarjen vertikale. Ndarja sektoriale matet me pjesëmarrjen e grave dhe burrave në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe punës sociale. Cilësia e punës matet në bazë të orareve fleksibël të punës dhe mundësive për karrierë. Fleksibiliteti regjistrohet në bazë të mundësisë së grave dhe burrave për të marrë një apo dy orë leje gjatë orarit të punës për të kryer aktivitete që lidhen me kujdesin për familjen. Indeksi i Mundësive për Karrierë mat aspektet e ndryshme të cilësisë së punësimit: vazhdimësinë e punësimit, përkufizuar me llojin e kontratës së punësimit, sigurinë e punës (probabilitetin e humbjes së punës në 6 muajt e ardhshëm), shanset për avancim në karrierë dhe shanset për organizimin e punës sa i përket numrit të punonjësve. Indeksi i Mundësive për Karrierë matet në një shkallë prej 0 deri në 100 pikë, ku vlera më e lartë tregon mundësi më të mira për karrierë.

Indeksi për fushën e punës në Shqipëri është 67.6 dhe më i ulët sesa mesatarja e BE-28 me 4.4 pikë. Siç e tregojnë edhe vlerat e indeksit për këto nënfusha, situata është shumë më e mirë sa i përket pjesëmarrjes sesa ndarjes dhe cilësisë së punës (figura 5). Shkalla e punësimit e ekuivalentuar me punësimin me kohë të plotë ishte 40.2 për qind për gratë dhe 54.6 për qind për burrat. Diferenca nga mesatarja e BE-28 është shumë e vogël në këtë aspekt, pasi shkalla e punësimit e ekuivalentuar me punësimin me kohë të plotë për gratë në BE ishte 40.8 për qind, kurse për burrat 56.9 për qind. E megjithatë ka dallime të dukshme gjinore. Këto dallime gjinore janë gjithashtu të dukshme edhe për treguesit që

matin kohëzgjatjen e jetës së punës si kohëzgjatje mesatare në Shqipëri, e cila për gratë është 31.2 vjet, kurse për burrat 40.5 vjet. Diferencat me mesataren e BE-28 duken më të vogla për gratë në moshë pune në Shqipëri sesa për gratë në BE (në BE është 33.4 vjet) dhe më të mëdha për burrat në Shqipëri sesa për burrat në BE (në BE është 38.3 vjet).


Figura 5: Indeksi i barazisë gjinore në fushën dhe nënfushat e punës, Republika e Shqipërisë, 2017



Në nënfushën e ndarjes dhe cilësisë së punës, indeksi tregon punësim më të lartë të grave sesa burrave në sektorët socialë të arsimit, shëndetit të njeriut dhe punës sociale. Sipas të dhënave të sondazhit të forcës së punës të vitit 2018, 13.8 për qind e grave të punësuar dhe 3.9 për qind e burrave të punësuar ishin të punësuar në këta sektorë. Situata nuk është shumë e ndryshme në BE-28, ku 30 për qind e punësimit të grave është pikërisht në këta sektorë, kurse 8.3 për qind e punësimit të burrave është në të njëjtët sektorë. Sa i përket fleksibilitetit në punë, ka një përqindje më të vogël grash sesa burrash që pretendojnë se mund të marrin një apo dy orë leje gjatë orarit të punës për t'u kujdesur për çështje personale ose familjare (23.6 përkundrejt 27.1 për qind). Edhe këtu, situata nuk ndryshon shumë nga BE-ja, pasi janë mesatarisht 22.8 për qind e grave dhe 27.3 për qind e burrave që deklarojnë të njëjtën gjë. Mundësitë për karrierë për gratë janë më të pakta sesa për burrat në Shqipëri (53.6 përkundrejt 56.0) dhe akoma më të ulëta nëse krahasohen me mesataren e BE-28 (63.7 për gratë dhe 62.6 për burrat).

Krahasuar me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me dy vendet kandidate, Shqipëria renditet 25/31 dhe shënon rezultat më të lartë se Hungaria, Polonia, Republika Çekia, Sllovakia, Greqia dhe Italia dhe më të ulëta sesa Rumania, Serbia, Bullgaria dhe Kroacia (figura 6).

Figura 6: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën e punës, Republika e Shqipërisë, 2017, BE-28 2017, Maqedonia e Veriut dhe Serbia²⁷



Politikat për Promovimin e Barazisë Gjinore në Fushën e Punës

Promovimi i barazisë gjinore është nën ombrellën e disa strategjive sektoriale në Shqipëri. **Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (SKPVBGj) 2016-2020**²⁸ nga katër qëllimet strategjike, përcakton njërin qëllim strategjik për fuqizimin ekonomik të grave dhe burrave me objektiv rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe reduktimin e hendekut gjinor në tregun e punës. Rezultatet e pritshme të këtij objekti janë rritja e aksesit të grave dhe burrave në programet e nxitjes së punësimit, si dhe përfshirja më e madhe e grave në shkencë dhe novacion me qëllim nxitjen e fuqizimit ekonomik. **Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2014-2020**²⁹ dhe masat e saj specifike në lidhje me barazinë gjinore, si dhe zbatimi i këtyre masave të përfshira në **Planin Kombëtar të Veprimit për Gratë Sipërmarrëse 2014-2020** për nxitjen e mundësive më të mëdha sipërmarrëse për gratë priten gjithashtu të përmirësojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe të ndihmojnë në uljen e hendekut gjinor. SKPVBGj 2016-2020 përfshin edhe fuqizimin ekonomik

të grave në zonat rurale si pjesë e objektivave të saj. Rezultatet e pritshme përfshijnë përforsimin e të drejtave të pronësisë së grave mbi tokën bujqësore, ofrimin e çerdheve dhe kopshteve në zonat rurale, si dhe rritjen e numrit të fermereve gra që përfitojnë nga skemat e subvencioneve dhe nga shërbimet e ekstensionit.

Ka disa programe për nxitjen e punësimit që kanë si objektiv gratë dhe gratë që vijnë nga kategori vulnerabël, si programe për nxitjen e punësimit të punëkërkuessve të papunë që janë në vështirësi,³⁰si dhe programe për nxitjen e punësimit të punëkërkuessve femra të papuna nga grupet e veçanta.³¹ I pari përfshin personat që nuk kanë pasur një punë për një kohë të gjatë dhe që kërkojnë asistencë sociale, individët që përfitojnë pagesë papunësie, ata që hyjnë në tregun e punës për herë të parë, individët e moshës 18-25 vjeç, individët mbi 45 vjeç që kanë vetëm arsimin e mesëm, personat me aftësi të kufizuara, romët, si dhe emigrantët e kthyer që hasin probleme ekonomike. Programi i dytë është projektuar për të integruar në tregun e punës gratë e marxhinalizuara si

27 Të dhënat për Maqedoninë e Veriut I referohen vitit 2015, kurse për Serbinë vitit 2016

28 Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020. 2016. <https://awenetwork.org/wp-content/uploads/2017/01/SKGJB-EN-web.pdf>

29 Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2014-2020. 2014. https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/NESS-ENG-8-1-15_final-version.pdf

30 VKM Nr. 48, datë 16.01.2008. <http://www.shkp.gov.al/sherbimet/programet-e-tregut-te-punes/>

31 VKM Nr. 27, datë 11.01.2012. <http://www.shkp.gov.al/sherbimet/programet-e-tregut-te-punes/>

gratë rome, gratë që kanë qenë viktime të trafikimit, gratë e moshuara dhe gratë që vuajnë nga aftësi të kufizuara, si dhe gratë viktime të dhunës. Raporti i monitorimit periodik të SKPVBGj 2016-2020 tregon se gratë përbëjnë 55 për qind të personave të punësuar përmes programeve të nxitjes së punësimit dhe 46 për qind të numrit total të personave të regjistruar si punëkërkuar të papunë në shërbimet e punësimit.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2014-2020 përfshin një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë dhe gjithëpërfshirëse në çështjen e punësimit dhe aftësive. Ajo synon nxitjen e fuqizimit ekonomik të grave dhe aksesin në asete prodhuese përmes: (i) heqjes së pengesave për mundësi trajnimi dhe punësimi, sidomos në sektorët që konsiderohen si shtytës të rritjes; (ii) krijimit të mundësive për gratë dhe veçanërisht për gratë e zonave rurale për të marrë pjesë në tregun formal të punës; (iii) adresimit dhe masave për pjesëmarrjen e ulët të grave në treg dhe për ndarjen gjinore të profesioneve përmes politikave të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore në fushën e tregut të punës, profilizimit me ndjeshmëri gjinore dhe këshillimit të punëkërkuarve të papunë; (iv) forcimit të kapaciteteve kombëtare për integrimin e qëllimeve për barazi gjinore në politika dhe në monitorim, duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin e programeve të nxitjes së punësimit, duke ndjekur një qasje të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore. Kjo strategji ofron tregues të qartë gjinorë dhe objektiva për matjen e arritjeve të saj.

Edhe një sërë strategjish të tjera kombëtare përfshijnë masa për barazi gjinore në fuqizimin ekonomik dhe rritje të punësimit të grupeve të ndryshme, si të rinjve dhe komuniteteve rome dhe egjiptiane. Në këtë aspekt, **Plani Kombëtar i Veprimit për të Rinjtë 2015-2020** vendos një objektiv specifik për nxitjen e punësimit të të rinjve përmes

politikave efektive të tregut të punës. Ky objektiv përfshin përmirësimin e kuadrit ligjor, ngritjen e programeve të fokusuara tek aktivitetet për aftësitë sipërmarrëse të të rinjve, rritja e numrit të kurseve të formimit dhe arsimit profesional, duke promovuar në të njëjtën kohë idetë novatore, si dhe njohjen e praktikave dhe aftësive profesionale, praktikave mësimore dhe diplomave nga vendet ku të rinjtë kanë qenë emigrantë. Megjithatë, kjo strategji nuk i referohet në mënyrë specifike barazisë gjinore dhe as ndonjë qasjeje të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore në këtë objektiv të saj. **Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020**³² përfshin gjithashtu në vizionin e tij disa objektiva lidhur me punësimin për përmirësimin e aksesit të këtyre komuniteteve në tregun e punës dhe në punësimin formal. Megjithatë, objektivat e punësimit vendosen për komunitetin në përgjithësi, pa iu referuar në mënyrë të posaçme barazisë gjinore. Ato përfshijnë integrimin e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës përmes arsimit dhe formimit profesional dhe programeve të nxitjes së punësimit, si dhe promovimit të aftësive sipërmarrëse dhe vetëpunësimit. E fundit, **Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri**³³ fokusohet kryesisht tek rritja e mundësisë së grave për të përfituar nga skemat e subvencioneve dhe nga shërbimet e ekstensionit.

Ndonëse fuqizimi ekonomik i grave dhe ulja e hendeqeve gjinore në punësim dhe në pjesëmarrjen në tregun e punës përbëjnë prioritetet kryesore të disa politikave, pjesëmarrja e grave në forcën e punës, ndarja gjinore e profesioneve, puna e papaguar në familje në zonat rurale, dallimet gjinore në paga, si dhe pozicioni i të rinjve dhe sidomos i vajzave në tregun e punës vazhdojnë të mbeten një sfidë në tregun shqiptar të punës, siç tregohet nga treguesit e tregut të punës.


32 Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020.

<https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/national-action-plan-for-integration-of-roma-and-egyptians-in-th.html>

33 Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri 2014-2020.

<https://bujqesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-per-zhvillimin-rural-dhe-bujqesor-2014-2020/>

3.3 Fusha e parasë




Pabarazitë gjinore në aksesin në burime financiare dhe në situatën ekonomike ku jetojnë gratë dhe burrat maten në **fushën e parasë**. **Nënfusha e burimeve financiare** përmban të dhëna mbi fitimet mujore të grave dhe burrave të matura me dy tregues. Treguesi i parë përfaqëson fitimet mujore me bazë punën, kurse i dyti përfaqëson të ardhurat mesatare neto të ekuivalentuara, të cilat përveç pagave, përfshijnë pensionet, përfitimet sociale, si dhe çdo formë tjetër të ardhurash³⁴. **Nënfusha e situatës ekonomike** mat ekspozimin e grave dhe burrave ndaj riskut të varfërisë dhe shpërndarjen e të ardhurave mes grave dhe burrave. Treguesit që përfshijnë këta komponentë të indeksit matin përqindjen e popullatës së parrezikuar të përfshihet në kufirin e varfërisë (të ardhurat e të cilëve janë në nivelin e 60 për qind të të ardhurave mesatare në vend ose mbi këtë nivel) dhe përqindjen e kuintilit më të ulët e më të lartë të të ardhurave sipas gjinisë.

Indeksi në fushën e parasë shënon 59.6 pikë dhe është më i ulët se mesatarja e BE-28 me 20.8 pikë. Vlera e këtij indeksi në nënfushën e situatës ekonomike është shumë më e lartë sesa në nënfushën e burimeve financiare (figura 7). Fitimet mesatare mujore në vitin 2018 për gratë shënonin 1023 sipas Standardit të Fuqisë Blerëse (PPS), kurse për burrat shënonin 1180 PPS. Edhe të ardhurat mesatare neto të ekuivalentuara ishin më të ulëta për gratë sesa për burrat (4322 PPS përkundrejt 4405 PPS). Diferencat sa i përket rrezikut të varfërisë nuk ishin të dukshme. Në vitin 2017, mes grave kishte një përqindje prej 78.1 personash që nuk ishin

në rrezik varfërie, ndërsa mes burrave kjo përqindje ishte disi më e ulët, 77.5 për qind. Dallimet gjinore në shpërndarjen e të ardhurave S20/S80 nuk ishin të konsiderueshme (13.4 për gratë dhe 13.5 për burrat).

Figura 7: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat e parasë, Republika e Shqipërisë, 2017 dhe BE-28 2017




34 Që të dy këta tregues pasqyrohen në Standardin e Fuqisë Blerëse (PPS), i cili është një monedhë artificiale që merr parasysh dallimet në nivelin e çmimeve mes vendeve.

Kur fusha e parasë krahasohet me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me tre vendet candidate të Ballkanit Perëndimor, rezultatet tregojnë se vlerat më të ulëta shënohen nga 5

vende ballkanike: dy shtete anëtare të BE-së (Rumania dhe Bullgaria) dhe tre vende candidate (Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Shqipëria) (figura 8).

Figura 8: Indeksi i barazisë gjinore në fushën e parasë, Republika e Shqipërisë 2017, BE-28 2017, Maqedonia e Veriut dhe Serbia³⁵



Politikat për promovimin e barazisë gjinore në fushën e parasë

Politikat dhe masat që kanë si synim uljen e varfërisë dhe pabarazisë me qëllim nxitjen e mirëqenies ekonomike nuk specifikohen në ndonjë strategji për uljen e varfërisë. Në këtë aspekt **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020**³⁶ synon përputhshmërinë me Agjendën Sociale të BE-së 2020. Si e tillë, ajo fokusohet te ngritja e një sistemi të mbrojtjes sociale për uljen e varfërisë dhe për zvogëlimin e pabarazive social-ekonomike përmes parandalimit dhe riintegritimit të masave sociale dhe të punësimit. Ulja e varfërisë pritet të arrihet përmes një mbulimi më të mirë dhe një specifikimi më të mirë të ndihmës ekonomike për të varfrit dhe për personat jashtëzakonisht të varfër, shoqëruar me shërbime të integruara sociale dhe me skema punësimi përmes programeve të nxitjes së punësimit. Masat e tjera përfshijnë edhe rritjen e transparencës dhe auditimit të skemave të ndihmës ekonomike, si dhe ngritjen e kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së ndihmës ekonomike. Kjo strategji parashikon edhe masa për shërbimet e integruara të kujdesit social në nivel kombëtar dhe lokal, që ato të jenë gjithë përfshirëse për të gjitha

kategoritë vulnerabël, duke përfshirë gratë kryefamiljare dhe viktimat e dhunës në familje. Megjithatë strategjia nuk përmban masa specifike gjinore, ajo përfshin disa tregues dhe objektiva gjinorë.

Përveç kësaj, është miratuar edhe një fond social, i financuar nga buxheti i shtetit, i cili do të mbështesë shërbimet e kujdesit social për njerëzit në nevojë. Ky fond do të financojë gjithashtu planet sociale lokale dhe do të mbështesë vazhdimësinë e shërbimeve për grupet vulnerabël. **Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale 2016-2020**³⁷ fokusohet specifikisht tek të dhënat e ndara në aspektin gjinor për përfshirjen sociale. Ky dokument fokusohet në rëndësinë e të dhënave dhe ndarjes së të dhënave në aspektin gjinor në hartimin e statistikave dhe kryerjen e analizave për informimin më të mirë të politikëbërësve për një përfshirje më të madhe sociale.

Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2014-2020 përfshin edhe disa masa për përfshirjen sociale, përmes zgjerimit të rrjetit social të sigurisë dhe sinergjive

35 Të dhënat për Maqedoninë e Veriut i referohen vitit 2015, kurse për Serbinë vitit 2016

36 Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020.
http://shendetesia.gov.al/wpcontent/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf

37 Dokumenti i politikës për përfshirjen sociale 2016-2020.
http://www.nationalplanningcycles.org/sites/default/files/planning_cycle_repository/albania/social_inclusion_policy_document_2016-2020.pdf


mes mbrojtjes sociale dhe punësimit. Qëllimi i përfshirjes sociale dhe punësimit është kalimi i njerëzve nga skemat e mbrojtjes sociale në punësim dhe në tregun aktiv të punës. Kjo strategji ka një objektivi specifik për reformimin e sistemit të asistencës sociale për shmangien e gabimeve dhe për rritjen e numrit të personave që përfitojnë nga ky sistem, duke e lidhur mirëqenien me riintegrimin në tregun e punës. Kjo përfshin edhe disa tregues dhe objektiva gjinorë.

Edhe **Plani Kombëtar i Veprimit për të Rinjtë 2015-2020** përfshin disa masa për mbrojtjen sociale për të rinjtë, sa i përket ofrimit të strehimit përmes kredive të buta dhe ngritjes së shërbimeve me bazë komunitetin. Më konkretisht, ky objektivi fokusohet në ngritjen dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të kujdesit social, duke u ofruar shërbime të rinjve dhe kategorive në nevojë, pa specifikuar masa specifike në aspektin gjinor. Po kështu, edhe **Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020** përfshin disa objektiva për mbrojtjen sociale për përmirësimin e përfshirjes së këtyre komuniteteve në programet e mbrojtjes sociale dhe për promovimin e

riintegrimin të tyre përmes punës. Këto masa janë të gjitha gjithëpërfshirëse për komunitetin në tërësi, pa ndonjë objektivi specifik sa i përket gjinisë.

Si pjesë e integritimit gjinor në programimin buxhetor, buxhetimi i përgjithshëm gjinor është pjesë e "Strategjisë së menaxhimit të Financave Publike të Shqipërisë 2014- 2020"³⁸ dhe e Ligjit Nr. 57/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ku është përfshirë për herë të parë koncepti i buxhetimit të përgjithshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Buxhetimi i përgjithshëm gjinor është përfshirë gjithashtu edhe në Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e qeverisë vendore", i cili krijoi mundësi për një buxhetim efikas me ndjeshmëri gjinore në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar lokal, duke përfshirë programimin buxhetor vjetor dhe afatmesëm, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin, si dhe auditimin e njësisve të qeverisë vendore. Janë 34 programe të buxhetimit të përgjithshëm gjinor për periudhën 2019-2021, që përfshijnë fonde për rritjen e sipërmarrjes së grave, rolin e tyre në bujqësi, arsimin profesional, si dhe fonde për strehimin e grave kryefamiljare pas dhunës, divorceve, etj.

3.4 Fusha e dijeve



Fusha e dijeve mat pabarazitë gjinore në arritjet dhe pjesëmarrjen në arsim, si dhe në ndarjen mes dy gjinive. **Nënfusha e arritjeve dhe pjesëmarrjeve në arsim** tregon statusin e suksesit të grave dhe burrave në arritjen e arsimit të lartë dhe angazhimin e tyre në format formale dhe joformale të arsimit. Situata matet përmes

dy treguesve: përqindjes së grave dhe burrave që kanë marrë një diplomë të shkollës së lartë dhe pjesëmarrjes së grave dhe burrave në arsimin dhe formimin formal dhe joformal gjatë gjithë jetës. Nënfusha e dytë synon **ndarjen gjinore** në arsimin e lartë, e cila matet me përqindjen e grave dhe burrave mes atyre që studiojnë

38 "Albania Public Finance Management Strategy 2014-2020." 2014. https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/09/Albanian_PFM_strategy_2014-2020-1.pdf


në fushat e arsimit, shëndetit dhe mirëqenies, shkencave humane dhe arteve.

Në fushën e dijeve, Shqipëria shënon një indeks prej 55,6, rezultat i ngjashëm në të dyja nënfushat (figura 9). Përqindja e personave me arsim të lartë është më e lartë mes grave se sa burrave (18.2 përqind përkundëjt 14.5 për qind). Pjesëmarrja në arsimin formal ose joformal, që tregon të mësuarin gjatë gjithë jetës është pothuajse e njëjtë mes grave dhe burrave (përkatësisht 10.8 dhe 10.2 për qind). Megjithatë, ndarja sipas fushave të arsimit është ende e dukshme. Mes grave që janë studente të arsimit të lartë, 44.3 për qind studiojnë në fushat e arsimit, shëndetit dhe mirëqenies, shkencave humane dhe arteve, ndërsa në të njëjtën kohë, janë 21.4 për qind e burrave që studiojnë në arsimin e lartë në të njëjtat fusha.

Rezultati i indeksit në fushën e dijeve është 7.9 pikë më i ulët në Shqipëri se sa mesatarja e BE-28. Diferenca në nënfushën e arritjeve dhe pjesëmarrjes në arsim është 17.5 pikë, kurse në nënfushën e ndarjes gjinore në arsim, Shqipëria shënon një tregues më të lartë prej 0.6 pikësh. Në BE-28, janë 25.6 për qind e personave me arsim të lartë mes grave dhe 24,7 për qind mes burrave. Përqindja e grave dhe burrave që marrin pjesë në të mësuarin afatgjatë është më e lartë (17.2 për qind për gratë dhe 16.3 për qind për burrat). Ndarja gjinore përbën ende një problem madhor në BE-28, ku 43.1 për qind e studenteve femra përqendrohen në fushat e arsimit, shëndetit dhe mirëqenies, shkencave humane dhe arteve, ndërkohë që janë vetëm 21.4 për qind e studentëve meshkuj që studiojnë në të njëjtat fusha.


Figura 9: Indeksi i Barazisë Gjinore në fushën dhe nënfushat

Figura 10: Indeksi i barazisë gjinore në fushën e dijeve, Republika e Shqipërisë 2017, BE-28 2017, Maqedonia e Veriut dhe Serbia³⁹




³⁹ Të dhënat për Maqedoninë e Veriut i referohen vitit 2015, kurse për Serbinë vitit 2016

e dijeve, Republika e Shqipërisë, 2017 dhe BE-28, 2017



Arritjet dhe pjesëmarrja në arsim **Ndarja gjinore në arsim**



Krahasuar me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me dy vende tjera kandidate, Shqipëria renditet e 24/31 dhe ka rezultat më të mirë se Estonia, Portugalia, Gjermania, Bullgaria, Rumania, Kroacia dhe Letonia (figura 10).

Politikat për promovimin e barazisë gjinore në fushën e dijeve

Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Para-Universitar (SZhAPU) 2014-2020⁴⁰ përcakton synimet dhe objektivat kryesore strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit dhe sistemit arsimor në Shqipëri në përputhje me Evropë 2020. Qëllimi i saj kryesor është ofrimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës që fokusohet te studentët dhe që mbështet zhvillimin social dhe ekonomik të vendit dhe një shoqëri të konsoliduar demokratike. Ajo përcakton prioritetet për ofrimin e një arsimit cilësor dhe një sistemi të garantimit të cilësisë, si dhe kualifikime profesionale të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave. Kjo strategji përfshin disa masa për ofrimin e bursave për studentët me merita akademike dhe për studentët nga kategoritë vulnerabël. SZhAPU 2014-2020 promovon aksesin në arsim për të gjithë nxënësit e arsimit të detyrueshëm, duke u fokusuar veçanërisht te fëmijët nga familjet vulnerabël, si dhe te komunikimi me fëmijët që nuk janë pjesë e sistemit arsimor. Ndonëse kjo strategji merr parasysh fëmijët nga grupet vulnerabël, ajo nuk ka një fokus specifik mbi barazinë gjinore apo masat shoqëruese për përmirësimin e barazisë gjinore përmes sistemit arsimor.

Në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2016-2020 nuk ka asnjë objektivi apo masë specifike për arsimin. Megjithatë, në planin e veprimit parashikohen disa tregues të veçantë sa i përket gjinisë në fushën e arsimit në zonat rurale që lidhen me objektivin e fuqizimit ekonomik të grave. Në të përfshihen gjithashtu edhe disa aktivitete për përmirësimin e programit arsimor në sistemin parashkollor në bazë të një analize gjinore, si dhe përfshirja e djemve dhe vajzave në parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë (SKPA) 2014-2020 përfshin si një prej shtyllave të saj kryesore ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe për të rriturit. Objektivat e saj përfshijnë rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve femra dhe meshkuj në arsimin dhe formimin profesional që nxisin punësimin në të ardhmen. SKPA 2014-2020 përfshin edhe një objektivi specifik për ngritjen e një sistemi AFP që përgatit një forcë pune të aftë për Shqipërinë e më gjerë. Si i tillë, kjo strategji parashikon edhe objektiva me fokus gjinor sa i përket AFP-së dhe punësimit që rrjedhin nga aftësitë dhe trajnimi i përfutur në sistemin AFP. Kjo strategji përfshin gjithashtu edhe objektiva


që lidhen me rikonceptualizimin e sistemit kombëtar publik AFP mbi parimet e barazisë dhe diversitetit, si dhe përfshirjes së barazisë gjinore dhe qëllimeve të diversitetit në programin AFP dhe në eliminimin e stereotipeve gjinore. Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i programit AFP synohet gjithashtu të bëhet në një mënyrë që ka ndjeshmëri për përkatësinë gjinore. Objektivat e tjerë përfshijnë ndërgjegjësimin për AFP dhe komunikimin me gratë dhe vajzat në zonat rurale, si dhe promovimin e të mësuarit të aftësive sipërmarrëse dhe sipërmarrjes së grave si një kompetencë kyçe që përfshin programet specifike për sipërmarrjen, të cilat kanë si objektivi gratë dhe vajzat, duke përfshirë edhe ato në zonat rurale. Programet për aftësitë drejtuese dhe menaxhuese fokusohen veçanërisht te gratë dhe vajzat dhe përfshijnë disa masa në funksion të objektivit të aftësive sipërmarrëse.

Arsimi është edhe në fokus të **Planit Kombëtar për Rininë (PKVR) 2015-2020** dhe **Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020**. PKVR 2015-2020 nuk përmban ndonjë masë specifike gjinore në objektivat e tij për arsimin, por fokusohet gjithsesi në ofrimin e përmirësimit të programit mësimor përmes përfshirjes së aftësive për jetën. Ai, gjithashtu, parashikon edhe një sërë masash për përmirësimin e cilësisë së arsimit, duke ulur numrin e nxënësve për klasë, duke përmirësuar kushtet teknike dhe laboratorike në shkolla, duke forcuar njësitë kërkimore – zhvillimore në arsimin e lartë, si dhe duke rritur programet e shkëmbimit me universitetet e BE-së e më gjerë. Ofrimi i programeve arsimore për të rinjtë jashtë sistemit arsimor dhe atyre nga grupet vulnerabël përmes hapjes së “shkollave të mbrëmjes” është gjithashtu një nga masat e parashikuara në këtë strategji. Megjithatë, këto masa nuk janë gjithëpërfshirëse në aspektin gjinor. Po kështu, edhe Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve dhe Republikën e Shqipërisë 2016-2020 nuk përmban ndonjë masë specifike për barazinë gjinore, por fokusohet në ofrimin e aksesit për këto komunitete në sistemin arsimor, pa u diskriminuar apo veçuar. Objektivat e këtij plani janë që të ketë më shumë vajza dhe djem që përfundojnë arsimin e detyrueshëm, si dhe një bashkëpunim më të mirë mes shkollave dhe shoqërive sociale për adresimin e rasteve të fëmijëve me probleme social-ekonomike.

40 Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Para-Universitar 2014-2020. 2014.

http://arsimi.gov.al/Wp-content/uploads/2018/08/Strategji_APU_dokumenti_perfundimtar_24_03_2015.pdf

3.5 Fusha e kohës




Fusha e kohës lidhet me dikotominë e punës së paguar dhe punës së papaguar në shtëpi dhe me kujdesin për fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes, si dhe me dikotominë e punës dhe kohës së lirë. Në nënfushën e aktiviteteve të kujdesit, hendeuku gjinor matet me kohën që gratë dhe burrat kalojnë duke u kujdesur për fëmijët, me edukimin e fëmijëve ose me kujdesin për anëtarët e moshuar të familjes apo personat me aftësi të kufizuara, si dhe me dallimin në punët e shtëpisë, si gatimi dhe punë të tjera të ngjashme. Nënfisha tjetër i referohet skemave të kohës së shpenzuar për aktivitete sociale, personale dhe qytetare që janë të rëndësishme për cilësinë e jetës, zhvillimin individual dhe mirëqenien, si dhe me pjesëmarrjen aktive në shoqëri përmes formave të ndryshme të pjesëmarrjes qytetare. Në këtë nënfushë, dallimi gjinor matet me kohën që gratë dhe burrat shpenzojnë në aktivitete sportive, kulturore dhe aktivitete të tjera jashtë shtëpie, kombinuar me angazhimin e tyre në aktivitete vullnetarizmi dhe bamirësie.

Indeksi i Barazisë Gjinore në Fushën e Kohës për Shqipërinë është 48,1. Kur shihet sipas nënfushave, vihet re se në nënfushën e aktiviteteve të kujdesit shënohet një vlerë pak më e lartë e indeksit se sa në nënfushën e aktiviteteve sociale (figura 11). Ka një dallim të ndjeshëm mes burrave dhe grave, sa i përket përqindjes së personave që shprehen se kujdesen për fëmijët apo nipërit dhe mbesat e tyre, për të moshuarit apo për personat me aftësi të kufizuara çdo ditë (51.1 përqind e grave dhe 24.6 përqind e burrave). Ky dallim është edhe më i dukshëm kur bëhet fjalë për gatimin dhe punët e përditshme të shtëpisë, duke qenë se ky aktivitet përbën 87.8 përqind për gratë dhe vetëm 16.1 përqind për burrat. Nga ana tjetër, gratë i kushtojnë më pak kohë aktiviteteve sportive, kulturore ose argëtuese jashtë shtëpisë çdo ditë ose disa herë në javë – 31.4 përqind në rastin e grave

dhe 43.9 përqind në rastin e burrave. Te gratë, 5.4 përqind janë të përfshira në aktivitete vullnetarizmi apo bamirësie të paktën një herë në muaj, kurse në rastin e burrave janë 3.4 përqind ata që merren me aktivitete të tilla.

Figura 11: Indeksi i barazisë gjinore në fushën dhe nënfushat e kohës, Republika e Shqipërisë, 2017 dhe BE-28 2017




Rezultati i indeksit për Shqipërinë në fushën e kohës është më i ulët se sa mesatarja e BE-28 me 17.6 pikë. Në BE, ka mesatarisht një numër më të vogël personash që kujdesen çdo ditë për fëmijët apo për anëtarë të tjerë të familjes sesa në Shqipëri (37.5 përqind e grave dhe 24.7 përqind e

burrave), duke shënuar kështu një dallim ende të ndjeshëm gjinor. Dallimi gjinor është shumë më i dukshëm në BE se sa në Shqipëri në lidhje me gatimin dhe punët e shtëpisë, ku 78.7 për qind e grave e kryejnë këtë aktivitet çdo ditë, ndërkohë që në rastin e burrave janë 33.7 për qind. Sa u përket aktiviteteve sportive, kulturore dhe aktiviteteve të tjera argëtuese të përditshme apo disa herë në javë, gratë dhe burrat janë në numër më të vogël në BE se sa në Shqipëri (27.5 për qind e grave dhe 31.9 për qind e burrave), duke shënuar edhe këtu një dallim të konsiderueshëm gjinor në

favor të burrave. Nga ana tjetër, mes grave dhe burrave në BE, ka një përqindje më të madhe të personave të përfshirë në aktivitete vullnetarizmi apo bamirësie të paktën një herë në muaj (12.2 për qind e grave dhe 11.4 për qind e burrave).

Krahasuar me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me dy vendet kandidate të BE-së, Shqipëria renditet 27/31 në bazë të vlerës së indeksit në fushën e kohës. Ajo është e pozicionuar mes Serbisë dhe Portugalisë dhe më lart se Sllovakia, Greqia dhe Bullgaria (figura 12).

Figura 12: Indeksi i barazisë gjinore në fushën e kohës, Republika e Shqipërisë 2017, BE-28 2017, Maqedonia e Veriut dhe Serbia⁴¹



Politikat për promovimin e barazisë gjinore në fushën e kohës

Masat dhe politikat strategjike që kontribuojnë në një stil të ekuilibruar jetese dhe në një ndarje të barabartë të punëve të shtëpisë, aspektit riprodhues dhe kohës familjare mes burrave dhe grave në fushën e kohës nuk janë të përfaqësuar në mënyrë të konsiderueshme. Pavarësisht se kufizimet që përbëjnë puna e papaguar dhe përgjegjësitë për punët shtëpiake për gratë njihen gjerësisht, ekziston një dallim në politikat në lidhje me ndarjen e barabartë të kohës dhe përgjegjësi shtëpiake të kohës mes grave dhe burrave. Gratë janë kryesisht përgjegjëse për punën e papaguar brendapërbrenda shtëpisë, si dhe për rritjen e fëmijëve dhe për përgjegjësitë që kanë të bëjnë me kujdesin për anëtarët e familjes, punët e shtëpisë, si dhe

kujdesin për të moshuarit. Nismat kryesore për një stil më të ekuilibruar jetese dhe për lehtësimin e grave nga përgjegjësitë e tyre për rritjen dhe kujdesin për fëmijët janë ndërmarë me ndryshimet e bëra në kuadrin ligjor. Në këtë aspekt, rishikimi i **Ligjit, datë “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” datë 11.05.1993 dhe ndryshuar më 9.03.2017**⁴² u njohu të drejtën baballarëve për të marrë leje për lindjen e fëmijës pas periudhës së detyrueshme për leje prej 63 ditësh që u jepet nënave. Edhe ndryshimet e bëra në Kodin e Punës i japin mundësi secilit prind të kërkojë leje lindjeje. Përveç kësaj, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka ndërmarë nismën **“Bëjmë detyrat e shtëpisë”** ku nxënësit vazhdojnë të qëndrojnë në shkollë edhe për dy

41 Të dhënat për Maqedoninë e Veriut i referohen vitit 2015, kurse për Serbinë vitit 2016


42 Ligji nr. 7703 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i datës 11.05.1993 dhe i ndryshuar më 9.03.2017. <http://www.iss.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/Ligji-nr-7703-date-11-05-1993-ndryshuar-deri-ne-mars-2017.pdf>

orë pas orarit mësimor për të bërë detyrat e shtëpisë dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore. Kjo nismë është ndërmarrë për të ofruar një mjedis të barabartë për fëmijët që vijnë nga shtresa të ndryshme social-ekonomike, në mënyrë që ata të bëjnë detyrat e shtëpisë dhe të kenë arritje më të mira arsimore. Gjithashtu, ajo u ofron nënave dhe familjeve me shumë kujdes për fëmijët, duke krijuar në këtë mënyrë një

mjedis më të favorshëm për nënat në tregun e punës.

Së fundmi, rishikimi i "Kodit të Punës"⁴³ ka sjellë dispozita për më shumë fleksibilitet në punë, duke përfshirë edhe të punuarin online dhe të punuarin nga shtëpia. Ligji kërkon që kjo lloj pune të gëzojë të njëjtat të drejta dhe kushte pune që u ofrohen edhe të punësuarve të tjerë.

3.6 Fushat e pushtetit



Në **fushën e pushtetit** hendeku gjinor matet përmes pjesëmarrjes në strukturat e pushtetit politik, ekonomik dhe social. **Nënfushat e pushtetit politik** përfshijnë tregues që matin raportin e grave me personat në cilësinë e ministrit të qeverisë dhe përqindjen e grave deputete në Parlamentin Kombëtar. Përveç kësaj, kjo nënfushë përfshin edhe treguesin e përfaqësimit të grave në pozicionet e përfaqësuesve në këshillat bashkiakë. **Nënfusha e pushtetit ekonomik** i referohet dallimit në menaxhimin e burimeve ekonomike përmes pozicioneve drejtuese dhe përfshin treguesit e pjesëmarrjes së grave në bordet menaxhuese ose mbikëqyrëse të kompanive më të mëdha në bursë dhe pjesëmarrjen në bordet ekzekutive të bankës qendrore. **Nënfusha e pushtetit social** përfshin treguesit që matin raportin e grave dhe burrave në bordet e organizatave që financojnë kërkimet shkencore, përqindjen në bordet

e kompanive të transmetimit publik dhe përqindjen në anëtarësinë e organeve më të larta vendimmarrëse të organizatave kombëtare sportive olimpike. Pushteti social mbulohet nga Indeksi i Barazisë Gjinore për shkak të ndikimit simbolik që ai ka tek shoqëria dhe aksesin në struktura dhe në pozicionet e pushtetshme në fusha të ndryshme.

Fusha e pushtetit është fusha, ku Shqipëria shënon një rezultat më të mirë se mesatarja e BE-28 me 60,9 pikë (9 pikë më ulët se mesatarja e BE-së)⁴⁴. Kjo vjen për shkak të rezultateve më të mira se sa mesatarja e BE-28 në nënfushat e pushtetit politik dhe ekonomik, ndërkohë që sa i përket pushtetit social, rezultati i Shqipërisë është më i ulët (figura 13). Gratë marrin pjesë në pozicione ministrore në Shqipëri me 45.4%, një shifër që është shumë më e lartë se sa 28.1% e mesatares së BE-28. Po kështu, gratë janë më të

43 Ligji Nr.136/2015 që bën ndryshime në Ligjin Nr. 7961 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", datë 12.07.1995. <https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/ELECTRONIC/100843/121198/F2036237860/ALB-100843.pdf>


44 Treguesit për fushën e pushtetit i referohen mesatares tre-vjeçare (2016, 2017, 2018). Më shumë detaje në Shtojcën 1 në tabelën me metadeta.

përfaqësuar në këshillat bashkiakë të Shqipëri se sa në BE (35.9% krahasuar me 28.5%). Megjithatë, ato janë disi më pak të përfaqësuar si deputete në parlament krahasuar me BE-28 (26.2 për qind krahasuar me 29.3 për qind). Pjesëmarrja e grave në pozicione drejtuese të kompanive më të mëdha është paksa më e lartë në Shqipëri se sa në mesataren e BE-28 (26.4 përqind krahasuar me 25.0 për qind) dhe shumë më e lartë kur vjen fjala tek anëtarësia e bordit te bankës qendrore (48.1 për qind krahasuar me 20.3 për qind). Pavarësisht këtyre rezultateve relativisht më të mira në përfaqësimin e grave në pushtetin politik dhe ekonomik në Shqipëri se sa mesatarja e BE-28, është e rëndësishme

të theksohet se ndasitë gjinore janë ende të pranishme dhe kërkojnë angazhime të mëtejshme. Prapë se prapë, burrat vazhdojnë të jenë shumica në të gjitha pozicionet e pushtetit politik dhe ekonomik.

Kur vjen fjala tek pushteti social⁴⁵, të dhënat tregojnë se ndonëse përfaqësimi i grave është relativisht i lartë në bordet e organizatave që financojnë kërkimet shkencore, ato janë më pak të përfaqësuar se sa duhet në bordet e organizatave transmetuese publike dhe në organet më të larta vendimmarrëse të organizatave kombëtare sportive olimpike, ku burrat zënë më shumë se 90% të pozicioneve.

Figura 13: Indeksi i barazisë gjinore në fushën dhe nënfushat e pushtetit, Republika e Shqipërisë, 2017 dhe BE-28 2017




Krahasuar me mesataren e BE-28, gratë në Shqipëri kanë një përfaqësim relativisht të lartë në bordet e organizatave që financojnë kërkimet shkencore krahasuar me mesataren e BE-28 (44.4 për qind krahasuar me 39.9 për qind), por ato janë shumë pak të përfaqësuar në bordet e organizatave transmetuese publike (9.1 për qind krahasuar me 36.0 për qind) dhe në organet më të larta vendimmarrëse të

organizatave kombëtare sportive olimpike (9.4 për qind krahasuar me 14.8 për qind).

Në krahasim me Shtetet Anëtare të BE-28 dhe me 2 vendet kandidate të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria renditet si 6/31, midis Spanjës dhe Bullgarisë (figura 14).

45 Të dhënat e përdorura për llogaritjen e pjesëmarrjes së grave në pushtetin politik janë përdorur nga Zyra e Kryeministrit, Parlamenti dhe Zyra Qendrore për Zgjedhjet, por të dhënat për pjesëmarrjen e grave në politikë mund të gjenden gjithashtu në bazën e të dhënave të Vendimmarrjes së grave dhe burrave të ElGE, <https://eige.europa.eu/gender-statistics/dgs/browse/wmidm>

Figura 14: Indeksi i barazisë gjinore në fushën e pushtetit, Republika e Shqipërisë 2017, BE-28 2017, Maqedonia e Veriut dhe Serbia⁴⁶



Politikat për promovimin e barazisë gjinore në fushën e pushtetit

Pjesëmarrja e barabartë e grave në jetën politike dhe vendimmarrjen publike ka vazhduar të përmirësohet dhe kodi zgjedhor kërkon që gratë të përbëjnë 30 për qind të kandidatëve në listat zgjedhore të partive politike që marrin pjesë në zgjedhje⁴⁷. Ai kërkon, gjithashtu, që secila gjini të përfshihet në tre emrat e parë të listës. Parlamenti shqiptar ka përfaqësimin më të madh të grave në tridhjetë vitet e fundit. Ka, gjithashtu, edhe një rritje të madhe në përfaqësimin e grave në qeveri. Qeveria aktuale është e ekuilibruar në aspektin gjinor. Pjesëmarrja e barabartë është edhe një prej qëllimeve strategjike të **Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të Veprimit (SKBGj) 2016-2020**. Përbushja e këtij qëllimi përfshin dy objektiva specifike. Objektivi i parë është rritja e vendimmarrjes publike të grave në pozicione drejtuese, si në ligjbërje, ashtu edhe në politikëbërje në nivel qendror. Ky objektivi parashikon një rritje prej 40 për qind të pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe publike. Objektivi i dytë përcakton një rritje prej 40 për qind të pjesëmarrjes së grave në procese politikëbërëse dhe në nivelin e lidërshiptit në planifikim në nivel lokal përmes rritjes së pjesëmarrjes në këshillat bashkiakë. Masat për arritjen e këtyre objektivave përfshijnë rritjen e pjesëmarrjes së grave në nivele drejtuese në organet e qeverisë qendrore, sidomos në proceset planifikuese, monitoruese dhe vlerësuese. Ai përfshin gjithashtu edhe

emërimin e grave në pozicione drejtuese dhe administruese në njësitë e qeverisë vendore për të arritur synimin prej 30 për qind të parashikuar me ligj. Në këtë aspekt, vëmendje e veçantë i duhet dhënë emërimit të grave nga grupet e marxhinalizuara dhe gratë me aftësi të kufizuara, grave të moshuara, si dhe grave nga komuniteti rom.

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (PKVR) 2015-2020 përfshin gjithashtu edhe disa objektiva për pjesëmarrjen e të rinjve në proceset demokratike dhe vendimmarrje. Fokusi vendoset tek avokimi me grupet politike për të promovuar dhe për të garantuar pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrjen në nivel lokal dhe arritjen e një pjesëmarrjeje prej 20 për qind të të rinjve në strukturat e qeverisë vendore. Ai përfshin gjithashtu edhe disa masa për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për të mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve edhe në proceset demokratike dhe vendimmarrëse. Kështu, ai përfshin disa aktivitete për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në qeveritë e shkollave dhe në këshillat e shkollave, si dhe ngritjen e Bordit të Konsultimit me Rininë në strukturat e nivelit qendror dhe lokal të qeverisë për të shërbyer si një strukturë konsultimi për të rinjtë për të gjitha fazat vendimmarrëse të zhvillimit dhe monitorimit të politikave për të rinjtë. Fokus gjinor u jepet gjithashtu edhe aktiviteteve ndërgjegjësuere në


⁴⁶ Të dhënat për Maqedoninë e Veriut i referohen vitit 2015, kurse për Serbinë vitit 2016

⁴⁷ Kombet e Bashkuara (2017). "Standardet e Përfaqësimit në Partitë Politike." http://www.un.org.al/sites/default/files/1.%20Gender%20ne%20Partite%20Politike%202017%20-%20Shqip_1.pdf

luftën kundër stereotipave gjinore dhe diskriminimit, duke promovuar në të njëjtën kohë pjesëmarrjen e vajzave në vendimmarrjen në jetën publike. Në këtë strategji, parashikohen gjithashtu aktivitete ndërgjegjësuese mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhjet politike dhe në përfaqësimin e tyre në vendimmarrje, së bashku me

ofrimin e trajnimeve për grupet e të rinjve për të forcuar aftësitë e tyre drejtuese. Megjithatë, në të nuk parashikohen politika specifike për fushën e kërkimeve shkencore dhe për financimin e aktiviteteve të kërkimit shkencor, si dhe në fushën e pushtetit social.

3.7 Fusha e shëndetit




Në **fushën e shëndetit**, pabarazitë gjinore ndahen në tre nënfusha: gjendja shëndetësore, sjellja kundrejt shëndetit dhe aksesit në kujdesin shëndetësor. Nënfusha që lidhet me **gjendjen shëndetësore** përfshin treguesit e vlerësimit subjektiv të shëndetit të grave dhe burrave, jetëgjatësinë e pritur që nga lindja dhe numrin e pritur të viteve të jetës së shëndetshme që nga lindja. Nënfusha **e sjelljes** përfshin treguesit që matin mbizotërimin e modeleve të sjelljes që përbëjnë rrezik për shëndetin, të tilla si pirja e duhanit dhe alkoolit, si dhe mbizotërimin e modeleve të sjelljes së shëndetshme - konsumi i frutave dhe perimeve dhe ushtrimi i aktiviteteve fizike. **Nënfusha e aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetësor** përfshin treguesit e nevojave të plotësuara për shërbimet mjekësore dhe dentare, të cilat matin raportin e grave dhe burrave që kanë raportuar se mund të kenë kryer kontrollin, të jenë diagnostikuar ose të kenë marrë terapi kur ka qenë e nevojshme.

Rezultati i indeksit në fushën e shëndetit është 81.8 dhe është 6.3 pikë më i ulët se mesatarja e 28 vendeve të BE-së. Duke parë kategoritë, është e dukshme se situata është

më e mirë në fushat e gjendjes shëndetësore dhe të aksesit, por më pak e favorshme në nënfushën e sjelljes (figura 15). Vërehet një dallim gjinor në vetëperceptimin e shëndetit. Personat që e vlerësojnë shëndetin e tyre si të mirë ose shumë të mirë, janë më pak gra se burra (78.9 për qind përkundrejt 83.9 për qind). Megjithatë, jetëgjatësia që nga lindja është mesatarisht më e lartë për gratë sesa për burrat (80.5 vite përkundrejt 77.4 vite), gratë jetojnë mesatarisht më pak jetë të shëndetshme se sa burrat (51.9 vite përkundrejt 54.6 vite). Kjo ndodh pavarësisht faktit se gratë janë më pak të ekspozuara ndaj disa prej faktorëve kryesorë të rrezikut shëndetësor, si pirja e duhanit apo konsumi i pijeve alkoolike të dëmshme. Madje, 95 për qind e grave nuk pinë duhan dhe nuk përfshihen në konsumin e pijeve alkoolike të dëmshme, ndërsa 60 për qind e burrave përfshihen në sjellje të tilla. Njëkohësisht, përqindja e grave që praktikojnë aktivitete fizike dhe konsumojnë fruta e perime është më e lartë se ajo e burrave (47.9 për qind përkundrejt 27.4 për qind). Dallimet në nevojat e paplotësuara për ekzaminimin mjekësor janë relativisht të vogla, pasi 80,1% e grave raportuan se nuk

kishin nevoja të paplotësuara kundrejt 81.9% të burrave. Po kështu, 79 për qind e grave dhe 80 për qind e burrave nuk kishin nevoja të paplotësuara për ekzaminim dentar.

Figura 15: Indeksi i barazisë gjinore në fushën dhe nënfushën e shëndetit, Republika e Shqipërisë dhe 28 vendet e BE-së, viti 2017



Në krahasim me mesataren e 28 vendeve të BE-së, është e dukshme se në Shqipëri mbizotërojnë më shumë modelet e sjelljeve të shëndetshme të grave dhe burrave. Ndërkohë që në 28 vendet anëtare të BE-së, 72.4 për qind e grave dhe 52.2 për qind e burrave nuk pinë duhan dhe nuk përfshihen në sjellje të dëmshme, në Shqipëri 95 për qind e grave dhe 60 për qind e burrave nuk raportojnë sjellje të tilla të rrezikshme. Në Shqipëri, gratë praktikojnë aktivitete fizike dhe konsumojnë fruta e perime mesatarisht më shumë se gratë në 28 vendet e BE-së (47.9 për qind përkundrejt 36.1 për qind), ndërsa burrat në Shqipëri e bëjnë këtë më pak se burrat në BE (27.4 për qind përkundrejt 40.1 për qind). Nevojat e paplotësuara për ekzaminimin mjekësor dhe dentar raportohen më shpesh midis burrave dhe grave në

Shqipëri sesa në 28 vendet e BE-së. Në 28 vendet e BE-së, raportohen 96.6 për qind e grave dhe 97.1 e burrave pa nevoja të paplotësuara për ekzaminime mjekësore dhe 96 për qind e grave dhe 96.3 për qind e burrave pa nevoja të paplotësuara për ekzaminime dentare.

Në fushën e shëndetit, Shqipëria renditet e 27-ta nga 31, në krahasim me 28 vendet anëtare të BE-së dhe dy vendet e Ballkanit Perëndimor kandidatë për në BE, duke u pozicionuar midis dy vendeve baltike - Estoni dhe Lituani (Figura 16).

Figura 16: Indeksi i barazisë gjinore në fushën e shëndetit, Republika e Shqipërisë 2017, BE-28 2017, Maqedonia e Veriut dhe Serbia⁴⁸



48 Të dhënat për Maqedoninë e Veriut i referohen vitit 2015, kurse për Serbinë vitit 2016

Politika për nxitjen e barazisë gjinore në fushën e shëndetit

Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2016-2020⁴⁹ e Shqipërisë ka përcaktuar katër prioritet kryesore strategjike, që përfshijnë: (i) investimin në shëndetin e njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës, (ii) mbulimin shëndetësor universal për të gjithë, (iii) fuqizimin e sistemit shëndetësor, duke vendosur në qendër njerëzit dhe (iv) përmirësimin e qeverisjes dhe bashkëpunimit ndërsektorial për shëndetin. Për zbatimin e këtyre prioritetëve strategjike, janë parashikuar masa të ndryshme. Masat përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit për zgjedhje më të shëndetshme jetese, përmirësimin e programeve ekzistuese shëndetësore duke përfshirë ekzaminimet dhe kontrollet shëndetësore, si dhe ofrimin e programeve të reja parandaluese dhe programeve për promovimin e shëndetit me në qendër zonat rurale. Masa të tjera përfshijnë rritjen e shërbimeve diagnostikuese, trajtuese dhe të rehabilitimit në nivel rajonal e lokal. Qëllimet specifike për gjininë nuk janë përfshirë; megjithatë, ato gjenden në masat që synojnë të ofrojnë kujdes më të mirë për nënat dhe të sapolindurit, aksesin e nënave në grupet mbështetëse për të nxitur ushqyerjen me gji dhe ekzaminimin falas për kancerin e gjirit, dhe kancer të tjerë specifike për gratë. **Plani i Veprimit i Promocionit Shëndetësor 2017-2021**⁵⁰, i cili nxit jetesën e shëndetshme, duke përfshirë një dietë të shëndetshme, promovimin e aktivitetit fizik, reduktimin e duhanpirjes, konsumimit të dëmshëm të alkoolit dhe përdorimit të drogës, përfshin masat specifike për gjininë në objektivat e tij strategjike. Plani i veprimit përcakton synimet specifike për gjininë në arritjen e objektivave të tij. Një nga objektivat e tij strategjike është rritja e ndërgjegjësimit për jetesën e shëndetshme dhe përdorimi i duhur i shërbimeve shëndetësore. Një tjetër objektiv strategjik përqendrohet në fuqizimin e mjediseve mbështetëse dhe nxitjen e ndërhyrjeve efektive për zbatimin e programeve të arsimit dhe të promocionit shëndetësor. Krijimi i komuniteteve të qëndrueshme për

mbrojtjen dhe promocionin e shëndetit dhe mirëqenies është objektiv i fundit i përcaktuar nga plani i veprimit. Synimet specifike për gjininë në përmbushjen e këtyre objektivave, përfshijnë përdorimin e duhur të shërbimeve të monitorimit të shtatzënisë, reduktimin e pirjes së duhanit të burrat dhe gratë, rritjen e ushqyerjes me gji, shëndetin riprodhues dhe veprimtaritë këshilluese në mbështetje të grupeve vulnerabël që përfshijnë dhe gratë.

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (PKVR) 2015-2020 dhe **Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020** përfshijnë gjithashtu objektiva për shëndetin, ndonëse nuk kanë në veçanti fokusin gjinor. PKVR 2015-2020 përmban objektiva strategjike për shëndetin e të rinjve, duke u përqendruar në integrimin me kultura sportive për të nxitur mënyra më të shëndetshme jetese dhe shëndetin për të rinjtë. Fokusi kryesor në shëndet lidhet me fuqizimin e zinxhirit shëndetësor në shkollë dhe me krijimin e shërbimeve praktike për të rinjtë. Për këtë, masat përfshijnë fuqizimin e nivelit të këshillimit shëndetësor në nivel parauniversitar, i cili do të pajiset me personel mjekësor dhe social, si dhe do të ketë infrastrukturën e nevojshme për organizimin e veprimtarive sociale e shëndetësore në shkollë. Krijimi i shërbimeve praktike për rininë synon rritjen e burimeve të informacionit dhe ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për shëndetin seksual dhe riprodhues. Plani i Veprimit Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020 përfshin gjithashtu objektivat për akses, në shërbimet kryesore të kujdesit shëndetësor, nga anëtarët e këtyre komuniteteve. Ai përfshin gjithashtu përmirësimin e informacionit shëndetësor dhe nxitjen e romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor.

49 Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2016-2020.
http://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Health-Strategy-2020_eng.pdf

50 Plani i Veprimit i Promocionit Shëndetësor 2017-2021.
<http://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Action-plan-Health-promotion-2017-2021.pdf>

4. Konkluzione

Republika e Shqipërisë ka botuar Raportin e saj të parë për Barazinë Gjinore sipas metodologjisë për llogaritjen e Indeksit të Barazisë Gjinore për Bashkimin Evropian (EIJE, 2017a). Indeksi i Barazisë Gjinore në Shqipëri arrin 60,4 duke treguar se nevojitet ende angazhim i madh për të arritur barazinë e plotë gjinore. Rezultati është shtatë pikë më i ulët se 28 vendet anëtare të BE-së.

Në fushën e pushtetit, Shqipëria ka shënuar arritje më të mëdha se shumica e shteteve anëtare të BE-së, kryesisht për shkak të pjesëmarrjes më të lartë të grave në vendimmarrje politike dhe ekonomike. Arritjet në fushën e punës dhe në shëndet janë më të ulëta, por dallimi nuk është aq i madh krahasuar me fushën e dijës, parasë dhe kohës.

Tabloja e shfaqur nga Indeksi i barazisë gjinore tregon arritje jokonsistente në fushat kryesore të barazisë gjinore (puna, paraja, dija, koha, pushteti dhe shëndeti), dhe jo vetëm mes këtyre fushave kryesore të barazisë gjinore, por shpesh edhe brenda së njëjtës fushë. Kjo duket edhe nga dallimet në pikë midis dy nënkategorive të fushës së parave. Situata është më e mirë sa u përket arritjeve më të larta dhe boshllëqeve disi më të ulëta në lidhje me rreziqet e varfërisë krahasuar me pagat dhe të ardhurave. Një tjetër shembull është fusha e shëndetit, ku situata është më e mirë sa i përket statusit shëndetësor dhe aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetësor sesa në sjelljet që lidhen me shëndetin. Gjithashtu, mund të përmendim fushën e pushtetit, një nga arritjet më të mëdha, pasi pushteti social nuk ndjek nivelin e arritjeve të pushtetit politik dhe ekonomik.

Indeksi i barazisë gjinore tregon se një nga pabarazitë thelbësore strukturore lidhet me ndarjen e gjinive si në fushën e njohurive, ashtu edhe të punës. Në lidhje me këtë, Indeksi i Barazisë Gjinore tregon se si pabarazitë strukturore gjinore mund të riprodhohen përmes fushave të ndryshme të marrëdhënieve gjinore që çojnë në pabarazi sistematike.

Ndonëse në raportin e parë, indeksi nuk llogaritet për fushat shtesë të dhunës në familje dhe për pabarazitë e kombinuara me karakteristika të tjera, kjo planifikohet të bëhet në ciklet e ardhshme të raportimit.

Republika e Shqipërisë njeh dhe kupton rëndësinë e barazisë gjinore. Kjo pasqyrohet në nismat e politikave dinamike dhe angazhimin e qartë strategjik për të nxitur barazinë gjinore dhe për të fuqizuar gratë në të gjitha fushat e treguara nga indeksi i barazisë gjinore. Megjithatë, siç tregojnë rezultatet, nevojitet ende shumë punë për të arritur barazinë e plotë gjinore. Kjo kërkon investimeve të mëtejshme në përpjekje dhe angazhim të madh të të gjitha palëve, duke përfshirë qeverinë në të gjitha nivelet, sektorët privatë dhe të shoqërisë civile, si dhe të gjithë qytetarët. Qeveria shqiptare mbetet e angazhuar të rrisë barazinë gjinore në të gjitha fushat she të ndërmarrë nisma që e mbështesin këtë angazhim. Ajo mbetet e angazhuar të rrisë programet e buxhetimit me ndjeshmëri gjinore për të mbështetur më tej fuqizimin ekonomik të grave, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivel lokal. Është gjithashtu e angazhuar të rrisë të drejtat e pronësisë së grave dhe aksesin e tyre në asete, siç tregohet nga ndryshimet në ligjin "Për noterinë", ku prona e fituar gjatë martesës duhet të regjistrohet në emrin e të dy bashkëshortëve. Gratë kanë edhe të drejtën të kërkojnë korrigjim të bashkëpronësisë në regjistrimin e pronave të fituara në martesë. Dhe, e fundit, kategorive vulnerabël, duke përfshirë edhe gratë vulnerabël dhe viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje, do t'u ofrohet ndihmë ligjore primare dhe dytësore falas.

Indeksi I Barazisë Gjinore ofron prova të rëndësishme dhe instrumente monitorimi për hartimin dhe zbatimin më me efikasitet të politikave. Ai do të përdoret nga qeveria dhe nga aktorë të tjerë, duke përfshirë edhe nga shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare në nismat e tyre me synim çuarjen përpara të barazisë gjinore.

Referencat

Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (2013a) *Raporti i Indeksit të Barazisë Gjinore*. Gjendet në

<http://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/Gender-Equality-Index-Report.pdf>

Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (2013b) *Indeksi i Barazisë Gjinore. Konstatimet kryesore*. Gjendet në

<http://eige.europa.eu/rdc/eige-publications/gender-equality-index-main-findings>

Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (2015) *Indeksi i Barazisë Gjinore 2015. Matja e barazisë gjinore në Bashkimin Evropian 2005-2012*. Zyra e Botimit e Bashkimit Evropian. Gjendet në

<http://eige.europa.eu/rdc/eige-publications/gender-equality-index-2015-measuring-gender-equality-european-union-2005-2012-report>

Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, 2017 (a). Indeksi i Barazisë Gjinore 2017: Raporti Metodologjik, gjendet në

<https://eige.europa.eu/gender-equality-index/publications>

Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, 2017 (b). Indeksi i Barazisë Gjinore 2017: *Matja e barazisë gjinore në Bashkimin Evropian 2005-2015*, gjendet në

<https://eige.europa.eu/publications/gender-equality-index-2017-measuring-gender-equality-european-union-2005-2015-report>

Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, 2017 (c). Indeksi i Barazisë Gjinore 2017: Kuadri i matjes së dhunës ndaj grave, gjendet në

<https://eige.europa.eu/publications/gender-equality-index-2017-measurement-framework-of-violence-against-women>

Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, 2019. Pabarazitë e ndërthurura: Indeksi i Barazisë Gjinore, 2019, gjendet në

<https://eige.europa.eu/publications/intersecting-inequalities-gender-equality-index>

Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, *Indeksi i Barazisë Gjinore 2019: Balanca Punë – Jetë*

<https://eige.europa.eu/publications/gender-equality-index-2019-work-life-balance>

Plantenga, J., Remery, C., Figueriredo, H. dhe Smith, M. (2009), 'Drejt Indeksit të Barazisë Gjinore të Bashkimit Evropian', Fletorja Zyrtare e Politikës Sociale Evropiane, 19(1) pp. 19–33.

Verloo, M. (2005), 'Zhvendosja dhe Fuqizimi: Reflektime mbi konceptimin dhe Praktikën e Qasjes së Këshillit të Evropës ndaj Integritit Gjinor dhe Barazisë gjinore' Politika Sociale: Studime ndërkombëtare për gjininë, shtetin dhe shoqërinë, 12(3), Fall, pp. 344–365.

Walby, S. (2005), 'Integrimi gjinor: Tensione produktive në teori dhe praktikë' Politika sociale: Studime ndërkombëtare mbi gjininë, shtetin dhe shoqërinë, 12(3) Fall, pp. 321–343.

Walby, S. (2009), 'Përtej politikës së vendit', Fuqia e argumentit në politikat e barazisë gjinore, pp. 36–51 in E. Lombardo, P. Meier dhe M. Verloo (eds), Politika digersive e barazisë gjinore: Shtrirja, Përkulja dhe politikëbërja. Londër: Routledge.

Shtojca 1:

Fushat, nënfushat, treguesit dhe burimet e të dhënave

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
Puna	Pjesëmarrja		Norma e punësimit ekuivalente me kohë të plotë (FTE) është një njësi për matjen e numrit të personave të punësuar në mënyrë të tillë që i bën ata të krahasueshëm edhe pse mund të punojnë për një numër të ndryshëm orësh në javë. Kjo njësi përfitohet duke krahasuar numrin mesatar të orëve të punës së një punonjësi me numrin mesatar të orëve që punon një person i punësuar me kohë të plotë. Kështu, një person i punësuar me kohë të plotë llogaritet si një FTE, kurse një person i punësuar me kohë të pjesshme vlerësohet në raport me numrin e orëve që ai apo ajo punon. P.sh., një person i punësuar me kohë të pjesshme për 20 orë në javë, aty ku puna me kohë të plotë konsiston në 40 orë, llogaritet si 0.5 FTE.	Eurostat, llogaritjet e EU LFS Eurostat me kërkesë të EIGE (2005-2015). Llogaritjet e EIGE 2017	2017	LFS 2018	
		Numri i viteve të punës (numri i viteve, popullata 15+)	Treguesi i kohëzgjatjes së jetës në punë (DËL) mat numrin e viteve, për të cilat një person i moshës 15 vjeç pritet të jetë aktiv në tregun e punës gjatë gjithë jetës së tij/saj. Ky tregues llogaritet duke kombinuar modelin e probabilitetit me të dhëna demografike (Tabelat e jetës nga Eurostat për llogaritjen e funksioneve	Eurostat, EU LFS Kohëzgjatja e jetës së punës – të dhëna të përvitshme	2017	LFS 2018	

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
			të mbijetesës) dhe me të dhënat e tregut të punës (Normat e aktivitetit të Sondazhit të Forcës së Punës me grupmosha individuale). Metodologjia e saktë e llogaritjes mund të kërkohej nga Eurostat.				
		Të punësuarit në Arsim, Shëndetin e Njeriut dhe aktivitetet të Punës Sociale (në përqindje, të punësuarit e grupmoshës 15+)	Përqindja e personave të punësuar në këto aktivitete ekonomike nga totali i personave të punësuar (bazuar në NACE Rev 2) përfshijnë: P. Arsimi + Shëndeti i Njeriut dhe Puna Sociale, si përqindje nga veprimtaritë TOTALE (TË GJITHA veprimtaritë e NACE).	Eurostat, EU LFS Punësimi sipas gjinisë, moshës dhe aktivitetit ekonomik (nga viti 2008 e në vijim, NACE Rev. 2) – 1,000 Punësimi sipas gjinisë, moshës dhe aktivitetit ekonomik (1983–2008, NACE Rev. 1.1) (1,000)	2017	LFS 2018	
	Ndarja dhe cilësia e punës	Mundësia për të marrë një apo dy orë leje gjatë orarit të punës për t'u kujdesur për çështje personale apo familjare (në përqindje, të punësuarit e grupmoshës 15+)	Përqindja e personave që mund të marrin një apo dy orë leje gjatë orarit të punës për t'u kujdesur për çështjet personale apo familjare (në përqindje, të punësuarit e grupmoshës 15+)	Eurofound, EWCS, llogaritjet e EIGE me mikro të dhëna	2015	LFS 2018	
		Indeksi i Mundësive për Karrierë (në pikë, nga 0 në 100)	Indeksi i mundësive është një prej indekseve të cilësive së punës të zhvilluara nga Eurofound. Ai kombinon treguesit e statusit të punësimit (i vetëpunësuar ose i punësuar), llojin e kontratës, mundësitë për zhvillim në karrierë sipas	Eurofound, EWCS llogaritjet nga Eurofound	2015	EËCS 2015	

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
			perceptimit të të punësuarit, probabilitetit të perceptuar të humbjes së punës dhe përvojës me uljen në detyrë brenda organizatës. Ky indeks matet me shkallën prej 0 deri në 100 pikë, ku sa më i lartë të jetë rezultati, aq më e mirë është cilësia e punës. Metodologjia e saktë mund të kërkohet nga Eurofound.				
Paraja		Fitimet mujore mesatare (PPS, popullata e punësuar)	Fitimet mujore mesatare sipas PPS (Standardit të Kapacitetit të Blerjes) në sektorët e Industrisë, ndërtimit dhe shërbimeve (përveç administratës publike, mbrojtjes, sigurimeve shoqërore të detyrueshme) (NACE_R2: B-S_X_O, grupmosha totale, persona që punojnë për kompani me 10 ose më shumë punonjës)	Eurostat, SES Fitimet mujore mesatare sipas aktivitetit ekonomik, gjinisë, moshës [earn_ses06_20] Fitimet mujore mesatare sipas gjinisë, moshës dhe aktivitetit ekonomik [earn_ses10_20] Fitimet mujore mesatare sipas gjinisë, moshës dhe aktivitetit ekonomik [earn_ses14_20]	2014	2018	
	Burimet financiare	Të ardhurat neto mesatare të ekuivalentuara (PPS, popullata 16+)	Të ardhurat e ekuivalentuara sipas PPS (Standardi i Kapacitetit Blerës) përbëjnë shumën e të ardhurave të një familjeje, pas zbritjes së tatimeve dhe detyrimeve të tjera, të cilat mbeten për t'u shpenzuar ose për t'u kursyer,	Eurostat, EU SILC Të ardhurat mesatare sipas moshës dhe seksit [ilc_dj03]	2017 BE-28: Mesatarja e paponderuar	SILC 2017	

Fusha	Nënfisha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
			të pjesëtuara me numrin e anëtarëve të familjes konvertuar në të rritur ekuivalent; anëtarët e familjes ekuivalentohen ose barazohen, duke e përcaktuar secilin sipas moshës, duke përdorur të ashtuquajturën shkallë të modifikuar ekuivalentimi të OECD-së.				
		Jo-në-risk-varfërie, ≥60përqind e të ardhurave mesatare (në përqindje, popullata 16+)	Treguesi i kthyer i "norma në-risk-varfërie", e llogaritur si 100 minus "norma në-risk-varfërie". Norma në risk varfërie është përqindja e personave me të ardhura të ekuivalentuara (pas transferimeve sociale) nën pragun e në-risk-varfërie, i cili përcaktohet në nivelin 60 për qind të të ardhurave të ekuivalentuara mesatare kombëtare pas transferimeve sociale.	Eurostat, EU SILC Norma e në-risk-varfërie sipas pragut të varfërisë, 2017 [ilc_li02]	2017	SILC 2017	
	Situata ekonomike	S20/S80 Përqindja kuintile e të ardhurave (popullata 16+)	Llogaritur si 1/"S80/S20 raporti i përqindjes kuintile të të ardhurave" * 100. Raporti i përqindjes kuintile të të ardhurave (referuar gjithashtu si raporti S80/S20) është matja e pabarazisë së shpërndarjes së të ardhurave. Ajo llogaritet si raport i totalit të të ardhurave të marra nga 20 përqind e popullatës me të ardhurat më të larta (kuintili më i lartë) me atë që merret nga 20 përqind e popullatës me të ardhura më të ulëta (kuintili më i ulët). Për këtë Indeks, përdoret versioni "i përmbysur" i këtij treguesi.	Eurostat, EU SILC llogaritjet e Eurostat sipas kërkesës së EIGE	2017	SILC 2017	

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
Njohuritë		Me arsim të lartë (në përqindje, popullata 15+)	Arritjet në arsim matin përqindjen e personave me arsim të lartë mes burrave dhe grave. Personat me arsim të lartë si niveli më i lartë i përfunduar me sukses (nivelet 5-8), përqindja nga totali i popullatës 15+.	Eurostat, EU LFS llogaritjet e Eurostat sipas kërkesës së EIGE (2005-2015). Llogaritjet e EIGE 2017	2017	LFS 2018	
	Arritjet dhe pjesëmarrja	Pjesëmarrja në arsim dhe trajnim formal ose joformal (në përqindje, popullata 15+)	Përqindja e personave që marrin pjesë në arsim dhe trajnim formal ose joformal, nga totali i popullatës 15+. Të mësuarit gjatë gjithë jetës përfshin të gjitha aktivitetet e të mësuarit që kanë një qëllim të caktuar, qofshin ato formale, joformale apo informale, të ndërmarrja në mënyrë të vazhdueshme me synim përmirësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave. Si periudhë reference për pjesëmarrjen në arsim dhe trajnim merret periudha prej katër javësh para intervistës.	Eurostat, EU LFS llogaritjet e Eurostat sipas kërkesës së EIGE (2005-2015). Llogaritjet e EIGE 2017	2017	LFS 2018	
	Ndarja	Studentët e arsimit të lartë në fushat e Arsimit, Shëndetit dhe Mirëqenies, Shkencave Humane dhe Arteve (studentët e arsimit të lartë) (në përqindje, popullata 15+)	Përqindja e personave që studiojnë në një nga këto fusha: EF14 (Pedagogji dhe shkencë arsimit) + EF2 (Shkencë humane dhe arte) + EF7 (Shëndetësi dhe mirëqenie) nga numri total i studentëve. Deri në vitin 2012, nivelet ISCED 5-6, më pas ISCED 5-8.	Eurostat, statistikat e Arsimit, studentët e arsimit të lartë (ISCED 5-6) sipas fushës së arsimit dhe gjinisë (2005-2012) [educ_enr15] (EF14 –Pedagogji dhe shkencë arsimit EF2 – Shkencë humane dhe arte EF7 –Shëndetësi dhe Mirëqenie) Studentët e regjistruar	2017 BE-28 llogaritjet me variablat fillestare BG, CZ, IE, EL, FR, HR, IT, CY, HU, MT, PT, RO, SK, FI, SE, UK. 2016. SI, 2016 për ED7 (Master ose ekuivalent)	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë për vitin akademik 2018/2019	

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
				në arsimin e lartë sipas nivelit të arsimit, orientimit të programit, gjinisë dhe fushës së arsimit (2013-2017) [educ_uae_enrt03] (F01 - Arsimi F02 – Arte dhe shkenca humane F09 – Shëndetësi dhe mirëqenie)			
Koha		Persona që kujdesen dhe që edukojnë fëmijët e tyre ose nipërit dhe mbesat, që kujdesen për të moshuarit ose për personat me aftësi të kufizuara, çdo ditë (në përqindje, popullata 18+)	Përqindja e personave të përfshirë në të paktën në një prej këtyre aktiviteteve të kujdesit jashtë punës së paguar çdo ditë: kujdesi për fëmijët, nipërit dhe mbesat, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.	Eurofound, EQLS Ilogaritjet e EIGE me mikro të dhëna	2016	EQLS 2016	
	Aktivitetet e kujdesit	Personat që gatuajnë dhe/ose bëjnë punë shtëpie çdo ditë (në përqindje, popullata 18+)	Përqindja e personave të përfshirë në gatim dhe/ose në punë shtëpie jashtë punës së paguar çdo ditë.	Eurofound, EQLS Ilogaritjet e EIGE me mikro të dhëna	2016	EQLS 2016	
	Aktivitetet sociale	Të punësuarit që merren me aktivitete sportive, kulturore ose aktivitete të tjera në kohën e lirë jashtë	Përqindja e personave që punojnë dhe që bëjnë aktivitete sportive, kulturore ose në kohën e lirë të paktën një herë në dy ditë (çdo ditë + disa herë në muaj nga totali).	Eurofound, EWCS Ilogaritjet e EIGE me mikro të dhëna	2015	EWCS2015	

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
Pushteti	Politik	shtëpie, të paktën çdo ditë ose disa herë në javë (në përqindje, të punësuarit e moshës 15+)	Përqindja e personave që punojnë dhe që përfshihen në aktivitetet vullnetare ose bamirësie të paktën një herë në muaj (në përqindje, të punësuarit 15+)	Eurofound, EWCS Ilogaritjet e EIGE me mikro të dhëna	2015	EĚCS2015	
		Përqindja e ministrave (në përqindje gra, burra)	Përqindja e ministrave. Raporti i bazuar në mesataren tre vjeçare dhe në raportin e secilës gjini në popullatë (18+). Qeveria qendrore (të gjithë ministrat: ministrat e rinj + ministrat me përvojë). Statistikat e popullatës bazohen në bazën e të dhënave të Eurostat.	EIGE, Baza e të Dhënave të Statistikave Gjimore, ĚMID Ilogaritja e EIGE	2016-2017-2018	Kryeministria, 2016-2017-2018	
		Përqindja e deputetëve (në përqindje burra dhe gra)	Përqindja e deputetëve në parlament. Raporti i bazuar në mesataren tre vjeçare dhe në raportin e secilës gjini në popullatë (18+). Parlamenti kombëtar (të dyja dhomat). Statistikat e popullatës bazohen në bazën e të dhënave të Eurostat.	EIGE, Baza e të Dhënave të Statistikave Gjimore, ĚMID Ilogaritja e EIGE	2016-2017-2018	Kuvendi i Shqipërisë 2016-2017-2018	
		Përqindja e anëtarëve në pushtetin vendor (në përqindje, burra dhe gra)	Përqindja e anëtarëve në organet e pushtetit vendor. Raporti i bazuar në mesataren tre vjeçare dhe në raportin e secilës gjini në popullatë (18+). Nëse në një vend nuk ekzistojnë	EIGE, Baza e të Dhënave të Statistikave Gjimore, ĚMID Ilogaritja e EIGE	Pushteti vendor 2016-2018 politika në nivel vendor 2017	Zyra Qendrore e Zgjedhjeve 2015-2016-2017	

Fusha	Nënfisha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
			organe të pushtetit vendor, merret parasysh politika në nivel lokal. Statistikat e popullatës bazohen në bazën e të dhënave të Eurostat.				
		Përqindja e anëtarëve të bordeve të kompanive më të mëdha në bursë, bordet mbikëqyrëse ose bordet drejtuese (në përqindje, burra dhe gra)	Përqindja e anëtarëve të bordeve në kompanitë më të mëdha në bursë. Raporti bazohet në mesataren tre vjeçare dhe në raportin e secilës gjini në popullatë(18+). Statistikat e popullatës bazohen në bazën e të dhënave të Eurostat.	EIGE, Baza e të Dhënave të Statistikave Gjimore, ĔMID Ilogaritja e EIGE	2016-2017-2018	Publikimi "Gratë në Borde dhe Pozicione Drejtuese në Kompanitë që Operojnë në Shqipëri"- 2016	Ky është një sondazh i realizuar në vitin 2016, ku ndërmarrjeve iu kërkua të raportonin përbërjen gjinore të bordeve të tyre.
		Përqindja e anëtarëve të bordit të bankës qendrore (në përqindje, burra dhe gra)	Përqindja e anëtarëve të bordit të bankës qendrore. Raporti bazohet në mesataren tre vjeçare dhe në raportin e secilës gjini në popullatë(18+). Statistikat e popullatës bazohen në bazën e të dhënave të Eurostat.	EIGE, Baza e të Dhënave të Statistikave Gjimore, ĔMID Ilogaritja e EIGE	2016-2017-2018	Banka Qendrore e Shqipërisë 2016-2017-2018	
	Social	Përqindja e anëtarëve të bordeve të organizatave financuese të kërkimeve shkencore (në përqindje, burra dhe gra)	Anëtarët e organeve më të larta vendimmarrëse të organizatave financuese të kërkimeve shkencore. Raporti bazohet në mesataren tre vjeçare dhe në raportin e secilës gjini në popullatë (18+). Statistikat e popullatës bazohen në bazën e të dhënave të Eurostat.	EIGE, Baza e të Dhënave të Statistikave Gjimore, ĔMID Ilogaritja e EIGE	2017-2018 IT: 2017	Baza e të dhënave e EIGE -2018	

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
		Përqindja e anëtarëve në organizata të organizata transmetuese publike (në përqindje, burra dhe gra)	Përqindja e anëtarëve në organizata transmetuese publike. Raporti bazohet në mesataren tre vjeçare dhe në raportin e secilës gjini në popullatë (18+). Statistikat e popullatës bazohen në bazën e të dhënave të Eurostat.	EIGE, Baza e të Dhënave të Statistikave Gjimore, ËMID Ilogaritja e EIGE	2016-2017-2018	Radio Televizioni Publik i Shqipërisë 2016-2017-2018	
		Përqindja e anëtarëve të organeve më të larta vendimmarrëse të organizatave sportive Olimpikë kombëtare (në përqindje, burra dhe gra)	Përqindja e anëtarëve të organeve më të larta vendimmarrëse të 10 organizatave më të njohura sportive Olimpikë kombëtare. Raporti bazohet në mesataren tre vjeçare dhe në raportin e secilës gjini në popullatë (18+). Statistikat e popullatës bazohen në bazën e të dhënave të Eurostat.	EIGE, Baza e të Dhënave të Statistikave Gjimore, ËMID Ilogaritja e EIGE	2015-2018	EIGE database-2018	
	Statusi	Shëndeti i vetëperceptuar, i mirë ose shumë i mirë (në përqindje, popullata 16+)	Përqindja e personave që e vlerësojnë shëndetin e tyre si "Shumë të mirë" ose "Të mirë" nga numri total i personave. Ky koncept përkthehet përmes pyetjes se si e percepton personi shëndetin e tij/saj në përgjithësi, duke përdorur një prej kategorive të përgjigjeve: shumë të mirë/të mirë/normal/të keq/shumë të keq.	Eurostat, EU SILC Shëndeti i vetëperceptuar sipas gjinisë, moshës dhe statusit të punës (në përqindje) [hlth_silc_01]	2017	SILC 2017	
Shëndeti		Jetëgjatësia në vlerë absolute në lindje (në vite)	Jetëgjatësia në një moshë të caktuar përbën numrin mesatar të viteve të tjera që një person i asaj moshe pritet të jetojë, nëse gjatë gjithë pjesës tjetër të jetës së mbetur të tij apo të saj ai do jetë në të njëjtat kushte aktuale vdekshmërie (probabiliteti specifik sipas moshës së vdekjes, d.m.th. norma e vdekjes të vërejtur për periudhën aktuale).	Eurostat, të dhënat për Vdekshmërinë Vitet e Shëndetshme të Jetës (nga viti 2004 e në vijim) [hlth_hiyel], treguesit F_0_LE – Jetëgjatësia e pritshme në vlerë absolute në lindje – femra dhe	2016 Totali: mesatarja për burrat dhe gratë	2018	

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
				M_0_LE - Vitet e jetës së shëndetshme në vlerë absolute në lindje.			
			Vitet e jetës së shëndetshme matin numrin e viteve që një person i një moshe të caktuar pritet të jetojë në kushtet kur nuk ka asnjë problem serioz apo të moderuar me shëndetin. Vitet e jetës së shëndetshme përbëjnë një tregues që kombinon të dhënat e vdekshmërisë me të dhënat e gjendjes shëndetësore nga minimoduli i shëndetit (EU-SILC): pyetja mbi vetëperceptimin, e cila synon të masë shkallën e çfarëdolloj kufizimi për të paktën 6 muaj për shkak të një problemi shëndetësor që mund të ketë ndikuar tek të intervistuarit sa u përket aktiviteteve që ata bëjnë zakonisht.	Eurostat, EU SILC dhe të dhënat e vdekshmërisë Vitet e Jetës së Shëndetshme (nga viti 2004 e në vijim) [hlth_hlye], treguesit F_0_DFLE –Vitet e jetës së shëndetshme në vlerë absolute në lindje–femra dhe M_0_DFLE –Vitet e jetës së shëndetshme në vlerë absolute në lindje - meshkujt	2016 Totali: mesatarja për burrat dhe gratë	SILC 2017	
		Vitet e shëndetshme të jetës në vlerë absolute në lindje (në vite)					
		Personat që nuk pinë duhan dhe që nuk janë të përfshirë në konsumim të dëmshëm pijesh alkoolike (në përqindje, popullata 16+)	Përqindja e personave që nuk janë të përfshirë në sjellje të rrezikshme, d.m.th. që nuk pinë duhan dhe që nuk janë të përfshirë në konsumim episodik pijesh alkoolike të rënda. Konsumi i rëndë episodik i referohet konsumimit të 6 pijeve ose 60+ gram alkooli të pastër në një rast të vetëm, çdo muaj ose më shpesh gjatë 12 muajve të fundit. Pija përkufizohet si një gotë vere, një gotë birrë, një gotë whiskey, etj. Çdo person i përfshirë në këto sjellje, qoftë në duhanpirje dhe/ose në konsumim të dëmshëm pijesh alkoolike konsiderohet si person me sjellje të rrezikshme.	Eurostat, EHIS Illogaritjet e Eurostat sipas kërkesës së EIGE	2014 BE-28: Mesatarja e paponduar-FR, NL: përlogaritja e EIGE	ADHS 2017-2018	

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
		Personat që ushtrojnë aktivitete fizike dhe/ose konsumojnë fruta dhe perime (në përqindje, popullata 16+)	Përqindja e personave që janë fizikisht aktivë të paktën 150 minuta në javë dhe/ose që konsumojnë të paktën 5 racione fruta dhe perime në ditë. Që të dyja këto pasqyrojnë rekomandimin zyrtar të OBSH-së. Eurostat ofron informacion mbi kohën e shpenzuar për përmirësimin e shëndetit (që nuk lidhet me punën), aktivitetin fizik dhe aerobik, ku përfshihen sportet dhe përdorimi i biçikletës për të shkuar nga një vend në tjetrin. Pesë racionet (400 g) fruta dhe perime nuk përfshijnë lëngjet e koncentratit dhe patatet.	Eurostat, EHS Ilogaritjet e Eurostat sipas kërkesës së EIGE	2014 BE-28: Mesatarja e paponderuar BE, NL: përlogaritja e EIGE	ADHS 2017-2018	
	Aksesi	Popullata me nevoja të paplotësuara për ekzaminim mjekësor (në përqindje, popullata 16+)	Nevojat e vetëraportuara si të paplotësuara për ekzaminime mjekësore. Variablat u referohen vetë vlerësimeve të intervistuarve nëse ata kanë pasur nevojë për ekzaminime apo trajtimit, por që nuk i kanë marrë ato. Përqindja e personave "Me asnjë nevojë të paplotësuara për t'u deklaruar", Kujdesi mjekësor: i referohet shërbimeve të kujdesit shëndetësor individual (ekzaminimit apo trajtimit mjekësor, duke mos përfshirë kujdesin dentar) ofruar nga mjekë ose nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të mjekëve ose nga profesionistë ekuivalentë sipas sistemit kombëtar të kujdesit shëndetësor.	Eurostat, EU SILC Nevojat e vetëraportuara si të paplotësuara si ekzaminime mjekësore sipas gjinisë, moshës, arsyeve të detajuara dhe kuintili i të ardhurave (në përqindje) [hlth_silc_08]	2017	SILC 2017	

Fusha	Nënfusha	Treguesi dhe popullata referencë	Përshkrimi	Burimi	BE-28 2017	Shqipëria	Shqipëria – përkufizimet e treguesve, nëse ndryshojnë
		Personat pa nevoja të paplotësuara për ekzaminim dentar (në përqindje, popullata 16+)	Nevojat e vetëraportuara si të paplotësuara për ekzaminim dentar. Variablat u referohen vlerësimeve të vetë të intervistuarve nëse ata kanë pasur apo jo nevoja për ekzaminime ose trajtimit, por që nuk i kanë marrë ato. Përqindja e personave "pa nevoja të paplotësuara për t'u deklaruar". Kujdesi dentar: i referohet shërbimeve të kujdesit shëndetësor individual ofruar nga stomatologë ose nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të stomatologëve (Dentistëve). Këtu përfshihet edhe kujdesi shëndetësor i ofruar nga ortodontët.	Eurostat, EU SILC Nevojat e vetëraportuara si të paplotësuara për ekzaminime dentare sipas gjinisë, moshës, arsyeve të detajuara dhe kuintili i të ardhurave (në përqindje) [hth_silc_09]	2017	SILC 2017	

Shtojca 2:

Rezultatet për fushat, nënfushat dhe vlerat e treguesve për Indeksin e Barazisë Gjinore për Shqipërinë 2020

FUSHAT	NËNFUSHAT	TREGUESIT	PIKËT
TOTALI			60.4
PUNA			67.6
	Pjesëmarrja		78.3
		Shkalla e punësimit e ekuivalentuar më kohë të plotë (%) G	40.2
		Shkalla e punësimit e ekuivalentuar më kohë të plotë (%) B	54.6
		Kohëzgjatja e jetës së punës (vjet) G	31.2
		Kohëzgjatja e jetës së punës (vjet) B	40.5
	Ndarja dhe cilësia e punës		58.4
		Të punësuar në arsim, shëndetësi dhe aktivitete të punës sociale (%) G	13.8
		Të punësuar në arsim, shëndetësi dhe aktivitete të punës sociale (%) B	3.9
		Mundësia për të marrë një ose dy orë leje nga puna gjatë orarit të punës për çështje personale ose familjare (%) G	23.6
		Mundësia për të marrë një ose dy orë leje nga puna gjatë orarit të punës për çështje personale ose familjare (%) B	27.1
		Indeksi i Mundësive për Karrierë (pikë, 0-100) G	53.6
		Indeksi i Mundësive për Karrierë (pikë, 0-100) M	56.0
PARAJA			59.6
	Burimet financiare		44.6
		Fitimet mujore mesatare (PPS) Gratë	1023
		Fitimet mujore mesatare (PPS) Burrat	1180
		Të ardhurat mesatare neto të ekuivalentuara (PPS) G	4322
		Të ardhurat mesatare neto të ekuivalentuara (PPS) B	4405
	Situata ekonomike		79.6
		Jo në rrezik varfërie (%) G	78.1
		Jo në rrezik varfërie (%) B	77.5
		Shpërndarja e të ardhurave S20/S80 (%) Ë	13.4
Shpërndarja e të ardhurave S20/S80 (%) M		13.5	

FUSHAT	NËNFUSHAT	TREGUESIT	PIKËT	
DIJET	Arritjet dhe pjesëmarrja		55.6	
			55.3	
		Me arsim të lartë (%) Gratë	18.2	
		Me arsim të lartë (%) Burrat	14.5	
		Marrin pjesë në arsimin formal dhe joformal (%) G	10.8	
		Marrin pjesë në arsimin formal dhe joformal (%) M	10.2	
	Ndarja		56.0	
		Studentë të arsimit të lartë në fushat e arsimit, shëndetësisë, mirëqenies, shkencë humane dhe arte (%) G	44.3	
		Studentë të arsimit të lartë në fushat e arsimit, shëndetësisë, mirëqenies, shkencë humane dhe arte (%) B	21.4	
KOHA	Aktivitetet e kujdesit		48.1	
			48.5	
		Personat që kujdesen dhe edukojnë fëmijët, nipërit e mbesat, që kujdesen për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara çdo ditë (%) G	51.1	
		Personat që kujdesen dhe edukojnë fëmijët, nipërit e mbesat, që kujdesen për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara çdo ditë (%) B	24.6	
		Personat që gatujnë dhe/ose bëjnë punë shtëpie çdo ditë (%) E	87.8	
		Personat që gatujnë dhe/ose bëjnë punë shtëpie çdo ditë (%) M	16.1	
	Aktivitete sociale		47.8	
		Punëtorë që merren me sport, aktivitete kulturore ose argëtuese jashtë shtëpisë, të paktën çdo ditë ose disa herë në javë (%) G	31.4	
		Punëtorë që merren me sport, aktivitete kulturore ose argëtuese jashtë shtëpisë, të paktën çdo ditë ose disa herë në javë (%) B	43.9	
		Punëtorë të përfshirë në aktivitete vullnetare ose bamirësie, të paktën një herë në muaj (%) G	5.4	
		Punëtorë të përfshirë në aktivitete vullnetare ose bamirësie, të paktën një herë në muaj (%) M	3.4	
	PUSHTETI			60.9
		Pushteti politik		71.7
Përqindja e ministrave (%) G			45.4	
Përqindja e ministrave (%) B			54.6	
Përqindja e deputetëve (%) G			26.2	
Përqindja e ministrave (%) B			73.8	
Përqindja në këshillat bashkiakë (%) G			35.9	
Përqindja në këshillat bashkiakë (%) B			64.1	
Pushteti ekonomik			74.5	
		Përqindja e bordeve të kompanive më të mëdha, bordet drejtuese ose bordet e drejtorëve (%) G	26.4	
	Përqindja e bordeve të kompanive më të mëdha, bordet drejtuese ose bordet e drejtorëve (%) B	73.6		

FUSHAT	NËNFUSHAT	TREGUESIT	PIKËT	
		Përqindja e bordeve të kompanive më të mëdha, bordet drejtuese ose bordet e drejtorëve (%) G	48.1	
		Përqindja e bordeve të kompanive më të mëdha, bordet drejtuese ose bordet e drejtorëve (%) B	51.9	
	Pushteti social			42.3
		Përqindja e përbërjes së bordeve të organizatave që financojnë studimet shkencore (%) G	44.4	
		Përqindja e përbërjes së bordeve të organizatave që financojnë studimet shkencore (%) B	55.6	
		Përqindja e përbërjes së bordeve të transmetuesve publikë (%) G	9.1	
		Përqindja e përbërjes së bordeve të transmetuesve publikë (%) B	90.9	
		Përqindja e përbërjes së organeve më të larta vendimmarrëse të organizatave sportive olimpike kombëtare (%) Ë	9.4	
		Përqindja e përbërjes së organeve më të larta vendimmarrëse të organizatave sportive olimpike kombëtare (%) B	90.6	
SHËNDETI	Statusi		81.8	
			91.6	
		Shëndeti si i vetëperceptuar, i mirë ose shumë i mirë (%) G	78.9	
		Shëndeti si i vetëperceptuar, i mirë ose shumë i mirë (%) B	93.9	
		Jetëgjatësia e pritshme në lindje (vjet) G	80.5	
		Jetëgjatësia e pritshme në lindje (vjet) B	77.4	
		Vitet e shëndetshme të jetës në lindje (vjet) G	51.9	
		Vitet e shëndetshme të jetës në lindje (vjet) B	54.6	
	Sjellja			67.0
		Personat që nuk pinë duhan dhe që nuk pinë në mënyrë të dëmshme (%) G	95.0	
		Personat që nuk pinë duhan dhe që nuk pinë në mënyrë të dëmshme (%) B	60.0	
		Personat që bëjnë aktivitete fizike dhe/ose që konsumojnë fruta-perime (%) G	57.9	
		Personat që bëjnë aktivitete fizike dhe/ose që konsumojnë fruta-perime (%) B	27.4	
	Aksesi			89.1
		Popullata me nevoja të paplotësuara për ekzaminime mjekësore (%) G	80.1	
		Popullata me nevoja të paplotësuara për ekzaminime mjekësore (%) B	81.9	
		Popullata me nevoja të paplotësuara për ekzaminime dentare (%) G	79.0	
Popullata me nevoja të paplotësuara për ekzaminime dentare (%) B		80.0		

